

KOSOVARJA

Ballina: Fisnik Syla

**Ka ardhur koha
me u marrë
lakmi
të vdekurve**

**Gjermani
që luftoi
në Kosovë,
tash në
Ukrainë**

**Fëmijët s'më
konsiderojnë
as për qen**



Fisnik Syla
siç nuk e njeh askush

**Cilat janë
miset politikane
të Kosovës**

**Fahrije Zogaj
e Bujar Durmishi
mjeshtrit e
muzikës live**

**Pse dua
të martohem
me dy burra**

**UB
shqiptaro-gjermane
takim me kryetarë
komunash
të Kosovës**



Cilat janë miset politike të Kosovës?

Të zonja, të afta, të guximshme, të bukura, janë disa nga veçoritë e tri politikeve tona: Vlora Çitaku, Blerta Deliu – Kodra dhe Duda Balje.



ISH-AMBASADORJA VLORA ÇITAKU

Me pamje të bukur dhe me oratori të pashoqe paraqitej në seancat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, kur ishte ambasadore e Kosovës në SHBA.

Por, i kaloi mandati dhe u kthye në Prishtinë...

Sidoqoftë, edhe pse Vlora më nuk është ambasadore, mbetet ambasadorja më e aftë që ka pasur Kosova në ndonjë ambasadë të saj dhe që, ndoshta, edhe shumë kohë nuk do të ketë.

Do të kishte qenë mirë që ajo edhe sot e gjithë kohën të ishte ambasadore, sepse e ka përfaqësuar Kosovën më mirë se cili do politikan yni. Dhe, me të drejtë mund të quhet krenaria e Kosovës.


Në anën tjetër, është për çdo lavd bukuria e saj...

BLERTA DELIU - KODRA, DEPUTETE

Blerta Deliu - Kodra që sa e sa vite është deputete e Kuvendit të Kosovës, nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës. Dhe, në secilën legjislaturë të Kuvendit është shumë aktive me diskutime, propozime e sugjerime të ndryshme, me interes për Kosovën.

Me profesion aktore, ma kujton Presidentin e tashëm të Ukrainës, Zelenskin, në qëndrimet e saj shumë të forta dhe me bazë reale.

Në anën tjetër, në Kuvendin e Kosovës ajo shndrit edhe me bukurinë e saj.



DUDA BALJE, DEPUTETE

Edhe Duda Balje, e lindur më 1977, me origjinë boshnjake, që disa mandate është deputete e Kuvendit të Kosovës, nga partia e Koalicionit "Vakat".

E patrembur, këmbëngulëse në qëndrimet e saj, janë disa nga veçoritë që e karakterizojnë deputeten në fjalë.

E veshur gjithmonë bukur, e hareshme, me pamje madhështore, Duda Balje me të drejtë mund të quhet "Misi i Parlamentit" të Kosovës.

Diturie Haxhaj



DINO KERAMIKA

Kush Jemi Ne HISTORIA DHE FILOZOFIA

Kompania DINO filloi si një biznes individual në vitin 2000. Gjatë viteve, grupi ka ndërmarrë shumë projekte sfiduese dhe aftësi të akumuluar, njohuri dhe përvojë në krijimin e zgjidhjeve, shërbimet e menaxhimit të projektit, tregtinë e ndërtesave dhe punimet inxhinierike të ngjashme, shitjen e qeramikës, bluarja dhe shitja e gurit, si dhe furnizimet me energji. Kompania ofron një cilësi të lartë për klientët, pavarësisht nga sektori, duke provuar veten lider të industrisë gjatë viteve. Kompania prodhon të gjitha klasat e betonit sipas standardeve të ndërtimit, si dhe transportin në destinacionin përfundimtar, prodhimin e të gjitha fraksioneve të zhavorit, shitjen dhe transportimin në destinacionin përfundimtar, furnizimin e të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit, furnizimin e qeramikës. Shitje me shumicë dhe pakicë nga fabrikat më të njohura italiane dhe shitja e drejtpërdrejtë e lokaleve të biznesit dhe apartamenteve. Kompania është Partner i autorizuar për furnizim me keramike



Magjistralja Prishtinë-Ferizaj, Konjuh - 14000 Lipjan



+383 49 566 667



Dino Qeramika



www.dino-company.com

Fisnik Syla

siç nuk e njeh askush...

Opinionin nuk e njehë siç do të duhej ta njihë Fisnik Sylën, biznesmenin e ri e të suksesshëm shqiptar në Belgjikë. Në fakt, prezantimi i tij në media nisi nga maja e ajsbergut dhe jo nga themeli. Fisnik Syla për publikun e gjerë, i njohur si biznesmen dhe ish-bashkëshorti i Fjolla Morinës, ka një CV të pasur, të mbushur me eksperiencë e suksese në fusha të ndryshme, përfshirë këtu sportin e muzikën.

I suksesshëm, i drejtpërdrejtë dhe i hapur rreth të kaluarës e të tashmes, Fisnik Syla i rrëfen të gjitha në versionin që njerëzit duhet ta dinë realisht.

Nuk kursehet në bisedat rreth biznesit, familjes, dy fëmijëve të tij dhe marrëdhënies me këngëtare Fjolla Morina.



Shkurt, kush është Fisnik Syla?

- Jam 31 vjeç, me prejardhje nga Gjilani. Deri në moshën 8 vjeç kam jetuar në Gjilan dhe që nga viti 1999 jetoj në Belgjikë.

Si të njehë publiku dhe si do të duhej të të njihë realisht?

- Sa i përket kësaj pyetje, ka dy anë të medaljes: Opinioni në Belgjikë më njeh si një lojtar shumë i mirë i futbollit. Kam luajtur në ligën e parë të Belgjikës, në Skuadrën "Lokeren", deri në moshën 17 vjeç. Por, shkakun e disa lëndimeve të rënda, mu desh ta ndërpres futbollin dhe fillova të bëj muzikë, si pasion me vëllanë tim, Fatosin. Kemi bërë disa videoklipe dhe kemi qenë pjesëmarrës në klube të ndryshme nëpër Evropë.

Ndërsa, me kalimin e kohës, meqë filluam me bizneset tona familjare, u larguam nga muzika për t'u fokusuar qind për qind në punë.

Por, që nga viti 2018 jam aktiv edhe në politikë, në regjionin ku jetoj dhe jam në Drejtorinë e komisionit menaxhues për hotelieri dhe evenimente, të cilin funksion e kam nga partia ime CD&V.

Ana e dytë e medaljes, veçanërisht publiku shqiptar më njohin me rastin e Kukësit, për të cilin u fol shumë në media dhe u zmadhua tepër.

Por, besoj se publiku tanimë më njeh realisht se kush jam dhe ndjehem mirë që respektohem kudo që ndodhem, sepse formula ime jetësore është njerëzit t'i respektoj dhe të jem mirënjohës.

Cila ishte jeta jote dikur, e cila është sot?

- Më vjen mirë që nga një fëmijë emigrant, meqë familja ishte e detyruar ta lëshojë vendin e të vijnë në një vend tjetër, jam shkolluar, jam formuar, jam kalitur si njeri dhe jam integruar në mënyrën më të mirë të mundshme në shoqërinë ku jetoj. Jam i kënaqur që gjërat kanë ecur mirë, ashtu siç edhe i kam pasur ambiciet e mija. Andaj, ndihem krenar me të kaluarën time, si dhe të tashmen në të gjitha aspektet.

Na fol për punën, biznesin tënd?

- Aktiviteti kryesor familjar yni është gastronomia, ku posedojmë disa restorante të ndryshme. Para një kohe kemi filluar edhe biznese me patundshmëri.

Për kuriozitet: Sa fiton në muaj?

- Fitoj mjaft dhe jam shumë i lumtur që puna që bëj me shumë pasion edhe më shpërblehet...

E, sa shpenzon?

- Shpenzoj shumë, sepse njeriu pas punëve dhe angazhimeve të përditshme e ndjen të nevojshme që edhe të bëj pushim të merituar.



A je i fiksuar në luks?

- Nuk jam i fiksuar, por më pëlqen ta shijoj jetën në çdo aspekt...

Nëse do të ktheheshe në të kaluarën, çfarë nuk do të bëje?

- Them lirisht se jam njeri me fat dhe gjërat gjithmonë kanë ecur ashtu siç kam dashur në jetën time. Pra, nuk do të ndryshoja as gjënë më të vogël.

Gjëja më e shtrenjtë në jetë për ty?

- Për mua shëndeti dhe familja, janë dy gjërat më të shtrenjta në jetë.

Personat pa të cilët nuk mundesh, nuk e imagjinon jetën?

- Pa dy fëmijët e mi: Diari dhe Darisi. Ata janë gjithçka për mua në jetë...

Raporti yt me gazetarët?

- Raportet e mija me gazetarët kanë qenë gjithmonë të mira. Si në Kosovë, Shqipëri, ashtu edhe në Belgjikë, gjithmonë kam qenë dhe do të jem i hapur t'u përgjigjem ftesave të tyre, ashtu siç kam vepruar gjithmonë.

A ke menduar se do të bëhesh i njohur e i përfolur siç je tash?

- Kjo pyetje lidhet me një pyetje e përgjigje paraprake: Në Belgjikë kam qenë gjithmonë i njohur, si në shoqëri ashtu edhe në media. Informatat e para për suksesin e bizneseve të mija dhe familjare, shtypi shqiptar i ka

marrë nga mediet belge, e edhe për aktivitetin tim politik.

A të pengon popullariteti në jetën e përditshme dhe në zhvillimin e biznesit?

- Nuk më pengon aspak. Përkundrazi, popullariteti im më ndihmon edhe në fushën e biznesit, veçmas kur shoh se njerëzit më nderojnë dhe më respektojnë kudo që ndodhem.

A je në lidhje dashurie?

- Jo. E kam cekur edhe më parë se aktualisht jam single, por i lumtur.

E kaluara jote me Fjolla Morinën ende është temë e nxehte në shou-biz. Pse përfundoi?

- Çdo gjë ka fillimin dhe përfundimin e vet. Kur krijon njeriu një lidhje, bëhet me dakordim të të dy palëve... Por, edhe me ndarjen është njëjtë. Secili prej nesh vazhdon jetën e vet...

Për fund, çka ka mbetur pa u thënë?

- Kam një mesazh për të rinjtë: Me punë, përkushtim dhe vullnet, arrihet gjithçka në jetë. Andaj, kurrë nuk është vonë për t'i ndjekur dhe realizuar ëndrrat tuaja... Ndërkaq, për biznesmenët dhe të tjerët që kanë mundësi, ndihmoni njerëzit në nevojë! Mos i lini t'u kërkojnë ata juve, por t'i gjeni nevojtarët vetë, sepse ky është biznesi më i mirë në jetë...

N. Neziri



Sa shtete i ka Kosova?

Shqiptarët andej lumit Ibër jetojnë në ankth të përhershëm. I kujtojnë “Rojat e urës”, serbë të akredituar për dhunë ndaj cilitdo shqiptar që e kalonte urën për në pjesën veriore të Mitrovicës.

Andaj, shumica e shqiptarëve janë larguar prej atje, duke i shitur banesat dhe shtëpitë, e disa duke i humbur ato me dhunë pa asnjë metelik! Ndërkaq, shqiptarët e mbetur atje shpresojnë të bëhet mirë, ndërsa ata që kanë oborre e tokë shpresojnë të ndërtojnë në të ardhmen, edhe pse Qeveria e Republikës së Kosovës atje pak e shtrinë dorën dhe ndikimin e shtetit...



Ç'THONË DISA NGA BANORËT QË JETOJNË NË VERI?

Elmedina, një banorë që jeton në pjesën veriore, kurse punon në pjesën jugore të Mitrovicës, ka thënë se në veri të Mitrovicës pak ndjehet fryma e shtetit të Kosovës.

“Nuk ka dorë shteti ynë andej lumit sa duhet, për të mos thënë fare. Jetohet sikur të ishte një shtet tjetër. Atje nuk ndjehet fryma e shtetit të Kosovës. As nuk mund të krahasohet jeta andej me këndeje lumit. Krejt këtë frymë të të jetuarit në dy shtete njeriu e ndjen në një hapësirë që e ndanë lumi Ibër. Nuk na ka dalë në mbrojtje askush. Ne, shqiptarët, në Veri jemi minoritet!

Frika është e pranishme te shqiptarët, sepse serbët lëvizin të organizuar për kriminalitet dhe maltretime, me qëllim të bëjnë presion që ne, shqiptarët, të largohemi prej pronave tona”, thotë Elmedina.

Ç'THOTË BANORJA E SUHADOLLIT?

Ardita, banorë në Suhadoll, udhëton çdo ditë për këndeje lumit Ibër.

“Pak a shumë, këtu, ku edhe jetoj unë, në Suhadoll, jetohet pak më mirë se në pjesë të tjera të Veriut të Kosovës.

Nga mosha tetëvjeçare jetoj këtu, në këtë shtëpi, në Suhadoll. Dhe, nuk kam frikë, sepse jetojmë në shtëpinë tonë, edhe pse

ka rreziqe. Jetojmë me të drejtën juridike se liria nuk duhet cenuar për askënd. Këtu luan rol edhe numri i madh i popullatës shqiptare që jeton numerikisht shumë më shumë se serbët”, thotë Ardita.

SI U ZVOGËLUA NUMRI I SHQIPTARËVE?

Vlen të kujtojmë se menjëherë pas lufte ka pasur më shumë shqiptarë sesa ka sot në këtë pjesë të Kosovës, por gradualisht janë shpërngulur nga presioni paramilitar serb, por edhe ai shtetëror nga Serbia. Dikush i ka shitur pronat, dikush i ka lëshuar duke mos parë siguri, sepse ka qenë një dhunë e orkestruar nga Serbia.

Megjithatë, kohëve të fundit gjendja është përmirësuar pak, edhe pse nuk mund të thuhet se ka siguri, meqë rreziku është i pranishëm, varësisht nga situata që ndryshon.

PSE NUK PO MUND TË NDËRPRITET KOLONIZIMI?

Sidoqoftë, edhe pse ka sado pak përmirësime në këtë pjesë të Kosovës, shteti i Kosovës nuk ka arritur të pengojë kolonizimin me serbë nga Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina.

Janë ndërtuar dhe po ndërtohen çdo vjet lagje të mëdha nga Serbia, në të cilat po vendosën kolonët serbë.

Shtrohet pyetja: Sa shtete i ka Kosova?

Selim Rama

NJË GOTË PËR JETËN!



**Njerëzit apo koha fajtores?
Sa keq: Sot vuajtjet e
njërit janë kënaqësi e
tjetrit!**

**Dikujt edhe shpirtin t'ia
falësh nuk ta vlerëson
kurrë! Nguten të të har-
rojnë kur nuk kanë nevojë
më për ty.**

**E, dihet se gjithçka që
jeton nuk jeton vetëm, as
veç për vetveten...**

**Im plak thoshte: Të rrëzo-
hesh shtatë herë dhe të
ngrihesh tetë herë, ky
është sekreti i jetës!
U kujtohet kur ishim
fëmijë - mezi pritnim të
rritemi...**

**Rrëzoheshim e lëndo-
heshim dhe prapë vazh-
donim lojën, ecjen...**

**Nga hapat e gabuar mëso-
jmë edhe të ecim...**

**E thotë përvoja: Barku i
uritur dhe xhepi i zbrazët
të japin mësimet më të
mira në jetë!**

**Ma tërhoqën vëmendjen
fjalët e njërit që rrinte
i vetëm në tarracën e
kafenesë "Pini", i cili, me
gjysmë zëri, këndonte:
"Ah moj jetë, jetë me hile...**

**Pse me t'keqin u bëre i
mirë**

**E me t'mirin u bëre katilë!"
Pastaj, i drejtohej vetes:
"Edhe një gotë për jetën -
gëzuar!"**

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Ardita Dili

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com



Cili është pasioni i Lorik Canës?

Lorik Cana mbetet një ndër ikonat e sportit shqiptar, një futbollist që ka pasur shumë suksese në fushën e gjelbër dhe që i ka mbrojtur denjësisht ngjyrat e Kombëtares shqiptare.

Është larguar nga Kosova në vitin 1990, kur ka qenë 7 vjeç. Cana nuk e ka pasion vetëm futbollin, por edhe shpejtësinë dhe veturat e shpjeta.

Kur e pyetën se cila është vetura e tij e preferuar, ai stepet dhe thotë se e ka të vështirë të vendosë, por në perspektivë për të "Porshe" mbetet një nga më të mirat.

Futbollisti vite me radhë ka vozitur një "Toyota" të vogël, sa një smart, që ishte krejt jashtë asaj që preferon në të vërtetë.




Për Xhensilën kush është mbretëresha e muzikës shqipe?

Këngëtarja Xhensila Myrtezaj është mjaft e pranishme me këngë e videoklipe dhe lë përshtypje të mirë edhe për pamjen dhe stilin që përçon.

Është modeste dhe pozitiviteti i saj ka arritur të transmetohet edhe te publiku që po e ndjekë me vëmendje. Ndryshe nga këngëtarët tjerë, e që nuk pëlqejnë të flasin për kolegët që u pëlqejnë, Xhensila thotë pa droje, pa kompleks, se kush janë zërat që i pëlqejnë më shumë.

"Më pëlqen Juliana Pasha, mbretëresha e muzikës sot për sot në Shqipëri. Gjithashtu, edhe motrat Libohova. Ndërsa, nga muzika botërore do veçoja Bioncen dhe të ndjerët Majkëll Xhekson dhe Vitni Hjuston".



Fatime Kosumi me album të ri

Fatime Kosumi është këngëtare me prejardhje nga Kosova, e që është lindur dhe jeton në Berlin të Gjermanisë.

Ka publikuar shumë këngë dhe disa albume. Albumi i saj i ri "Maleve" vazhdon të jetë një ballafaqim me sfidat dhe kufizimet e shkaktuara nga të jetuarit në një shoqëri patriarkale.

Dhe, duke shtuar tema nga emigracioni, ajo në këtë album ofron një pasqyrë më të plotë të traumës që përshkonte brezat e kaluar të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave kosovare.

Udhëtimi për të përfunduar albumin "Maleve" ishte i gjatë, i ndërlikuar nga humbje personale dhe situata globale. Megjithatë, kujdesi me të cilin ajo e krijoi këtë album emocionues dhe poetik, mund të ishte arritur vetëm përmes një periudhe të tillë reflektimi.

Me dëgjimin e parë, mund të duket se albumi "Maleve" është krijuar për hir të atyre burrave dhe grave që janë subjekt i këngëve.

Cilat janë prezantueset kosovare seksi?

LIBERTA SPAHIU

Liberta ka qenë modele që në moshë të re, ka luajtur në film. Liberta në botën e televizionit fillimisht u angazhua si prezantuese e motit, e tani është producente dhe prezantuese.

Babai i saj, Besniku, psikolog i njohur. Liberta është kunatë e ish-modeles së njohur, Diellza Bunjaku, e që është martuar me vëllanë e Libertes.

Ndonëse është paksa në moshë, Liberta duket si 18-vjeçare. Ushtron shumë në fitnes, bën tretman të ndryshëm, por ende asnjë operacion plastik.

Pa dyshim, mban kreun e listës së prezantueseve më të bukura.



BLERONA ZEQRIRI

Dikur ishte, thjesht, një adhuruese e të njohurve. Dhe, babai i saj, duke parë dëshirën e madhe të së bijës për të qenë pjesë e televizionit, bëri krejt çka mundi që ajo të jetë aty ku donte. Andaj, Blerona, ende pa i mbushur 13 vjeç, u bë pjesë e ekranit, duke prezantuar formate televizive për të rinj.

Asaj në moshë të re iu dha shansi që të prezantonte përkrah Labit në "1 kafe me Labin", e më pas në "Bon-bon". Ka thënë se Labinot Gashi e ka ngritur profesionalisht, për çka i është falënderuese.

Tani prezanton emisionin "1 kafe prej shpisë" dhe po e realizon mirë. Blerona komentohet për format e saj fizike dhe peshën që e ka ndryshuar shumë.



Nuk mbulohet nga pluhuri i harresës...



Ç'kemi të përbashkët unë dhe Zijadin Sela?

Në kohën kur e rrahën në Parlament deputetin shqiptar të Maqedonisë, Zijadin Selën, duke e tërhequr zvarrë pallatit të legjislativit civilë të përkatësisë maqedonase, mu kujtua Gjergj Elez Alia, por edhe rasti im...

E tërhiqnin zvarrë, duke e lënë të përgjakur në dyshemenë e parlamentit maqedonas, për faktin se shqiptarët morën për të parën herë një post të lartë në shtetin e tyre, në Maqedoni.

Pamja ishte tronditëse, aq sa u shfaqë në një sallë ku ishte organizuar një takim që kishte për temë "Maqedoninë dhe krizën ballkanike". Ishte aty Xhozef Diogardi, ish-in aty kongresmenë dhe analistë, ku në mesin e tyre edhe zëvendësndihmës sekretari i shtetit amerikan, Hoyt Eee.

Të pranishmit ngrinin në vend me ato pamje. I ngulitën sytë në pamjet tronditëse se si maqedonasit e ngrehnin zvarrë trupin e një shqiptari që dukej si i vdekur.

Në çast m'u rikthye mendja te koha e studimeve: Lexoja me ëndje luftërat e bajlozëve me Gjergj Elez Alinë, që dergjej në shtrat shtatë vjet me shtatë plagë në trup.

M'u kujtuan edhe këngët e ciklit të kreshnikëve, Mujit e Halilit, duke luftuar me kralitë serbë...

M'u kujtuan detajet se si, në fund, prehej koka e të mundurit, me të cilën dëshmohej se kush e kishte fituar dyluftimin...

Por, Zijadin Sela nuk e kishte humbur në dyluftim. Ai ishte sulmuar nga dhjetëra kriminelë maqedonas, të cilët e rrahën dhe e goditën me sende të forta derisa e shtrinë për tokë, duke e tërhequr zvarrë për të vdekur në parlament dhe duke ua treguar trupin e tij të gjithë atyre që nuk ishin bindur

tashmë se maqedonasit dominojnë në Maqedoni!

Ç'MU KUJTUA VITI 1981?

M'u kujtua viti 1981, kur më rrahën tri ditë e tri net rresht policët e asaj kohe në Prishtinë. Babai, e që ishte me ideologji balliste, posa u ktheva nga burgu, më tha:

"Mos më daltë shpirti pa e takuar filanin... (po ia kursej emrin se ishte shqiptar). E, kur ta takoj do t'ia fus tytën e pushkës në fyt dhe me tytë mbi kokën e tij do u them të pranishmëve se ai ka rrahur shqiptarë. Pastaj, do ia shkreplumbin në kokë.


Dhe, kur t'ia shkrepi plumbin në kokë do të bëjë jehonë që të tjerët të dinë si të sillen me popull".

Sokol Murturi



remos® KA PUNË PËR TY!

Çka ne po kërkojmë është: **Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier**



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës
Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
**Frankfurt, Köln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.**

Na kontaktoni në info@remos-restaurants.de



remos_restaurants

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de

Unioni i bizneseve shqiptaro-gjermane *takim me kryetarë komunash të Kosovës*

Unioni i bizneseve Shqiptaro-gjermane, si gjithëherë, edhe kohëve të fundit është mjaft aktiv. Udhëheqësit e Unionit: Nazmi Viqa - kryetar, Zenun Krasniqi - nënkryetar, Vllaznim Kelmendi - Drejtor për financa, Nexhmedin Veliqi - Sekretar dhe Bekim Borovci - anëtar kryesie, qëndruan në Kosovë dhe u pritën në takim pune nga kryetari i komunës së Ferizajt, Agim Aliu, kryetari i Komunës së Prishtinës, Përparim Rama, si dhe nga Nora Hasani, drejtoreshë e OEGJK-së.



TAKIMI ME AGIM ALIUN

Përfaqësuesit e Unionit të bizneseve shqiptaro-gjermane u informuan nga kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu për aktivitetet e tij të deritashme dhe për programin e ri të investimeve në komunën e Ferizajt. U shtjelluan tema aktuale në fushat e ekonomisë dhe mundësisë së optimimit të proceseve për investime nga diaspora.

Në vazhdim u vizatua projekti investues në Ferizaj nga Kryetari i Unionit, Nazmi Viqa.



TAKIMI ME PËRPARIM RAMËN

Kryesia e Unionit të bizneseve shqiptaro-gjermane, në përbërje: Nazmi Viqa - kryetar, Zenun Krasniqi - nënkryetar, Vllaznim Kelmendi – Drejtor për financa, Nexhmedin Veliqi - Sekretar, Remo Rashica dhe Bekim Borovci - anëtar kryesie, u pritën në takim pune nga kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama.

Kryetari Rama i shprehëm urimet më të sinqerta për marrjen e detyrës së kryetarit të Prishtinës, duke i shprehur gatishmërinë për shtrirje të bashkëpunimit në të gjitha fushat me interes publik, por edhe me interes të përbashkët.

Ata nga kryetari Rama u informuam për aktivitetet e tij të deritashme dhe për programin e tij transformues të kryeqendrës së Kosovës. Gjithashtu, u tha se komuna e Prishtinës së shpejti do krijojë zyrën për Diasporën, e cila do të jetë dera e parë institucionale në nivel lokal për nevojat e pjesëtarëve të Diasporës, por edhe për komunitetin e biznesit nga Diaspora.



TAKIMI ME NORA HASANIN

Sekretari gjeneral i Unionit të bizneseve shqiptaro-gjermane në Gjermani, Nexhmedin Veliqi, u prit në takim nga drejtoresha menaxhuese e OEGJK-së, znj. Nora Hasani. Gjatë takimit u diskutua rreth thellimit të bashkëpunimit ndërmjet OEGJK-së dhe Unionit të bizneseve shqiptaro-gjermane në Gjermani, si dhe rreth shkëmbimit të përvojave ndërmjet dy organizatave.

Në ditën e harresës...

Shkoj në zyrë

në stilin e kryeministrit!

Dola në zyrë si në stilin e kryeministrit, duke harruar çka ka premtuar dje e çka po premtonte sot. Në fakt, i kisha harruar çelësat e zyrës së punës.

Erdha te zyra dhe kur desha ta hap derën, çelësat s'i kisha askund...

U ula të pres derisa të vjen i dyti dhe u gëzova shumë kur pash se ai po vjen drejt zyrës, edhe pse ishte vonuar për në punë rrafsh një orë...

Kur erdhi të dy buzëqeshëm me të madhe. Unë u gëzova për faktin se ai do ma hapte derën, e ai u gëzua me faktin se unë kisha ardhur i pari dhe e kisha hapur derën.

"Hapma derën se i kam harruar çelësat!", i them unë.

"Unë u gëzova që ke ardhur ti para meje se edhe unë i kam harruar çelësat!", ma ktheu ai.

SILLU E PËSHTILLU ME DUAR NË XHEPA...

Mbetëm të dy para zyrës me duar në xhepa. Dhe, pasi nuk kishte zgjidhje tjetër, i hipa veturës për të shkuar në shtëpi t'i marr çelësat.

Gruaja, që sapo ishte kthyer nga puna para kohe, po priste te dera.

"Mirë se erdhe njeri se i kam harruar çelësat e derës së shtëpisë në punë dhe

nuk kisha mundësi të hyja brenda!", më tha ajo posa më pa.

Kthehem me gruan në punë t'i marrim çelësat dhe kolegja e saj, që sapo ishte kthyer nga kafeneja, i kishte harruar çelësat e zyrës në lokalin ku pinë zakonisht kafe...

"Harresë pas harrese!", i them gruas dhe vazhdova:

"Sikur të isha ndonjë faktor, e kam një ide: Të shpall këtë ditë "ditë e harresës" dhe kjo nuk do të ishte pak për njerëzimin, sepse duke e shpallur ditë të harresës një ditë në vit, do të kujtoheshin shumë e shumë gjëra të mëdha e të rënda që ka pësuar njerëzimi.

Dikush do të thoshte mos e harroni luftën e fundit në Kosovë...

Dikush do të thoshte mos i harroni femrat e dhunuara...

Dikush tjetër do të thoshte mos harroni

çka keni premtuar në fushatën parazgjedhore...

Prandaj, kjo ditë, kur të shpallej ditë e harresës, njerëzit do e luftojnë harresën, duke i rënë refresh trurit për ta kujtuar të keqen e një kohe".

2 PRILLI – DITA E HARRESËS!

Kjo datë ishte 2 prilli, një ditë pas ditës së rrenave. Nëse ia vlen të ekzistojë 1 prilli, si ditë e rrenave, patjetër e vlen të ekzistojë edhe 2 prilli, por si ditë e harresës.

Sepse, unë i kisha harruar çelësat e zyrës në shtëpi, kolegu i kishte harruar çelësat e zyrës, po ashtu, në shtëpi. Por, edhe gruaja ime i kishte harruar çelësat e shtëpisë në zyrën e saj!

Pra, harresë pas harrese...

S. Murturi


HELPER
GENEVE



www.helferwatches.com

 /helfer_lifestyle



Ka ardhur koha t'u marrim lakmi të vdekurve!

Besë nuk ka as dashuria. Nëse dikush të dërgon mesazh dashurie, pas tij mund të qëndrojë një therrë që shkatërron gjithçka shpirtërore. Por, kur pret që jeta të merr kah rrënues, ndodh që vjen gëzimi e hareja. Të papriturat e jetës nuk kanë të mbaruar, ashtu sikur thoshte poeti arbëresh Vorea Ujko, se kur pret dashurinë vjen vdekja, e kur pret vdekjen vjen dashuria.

Më në fund, krejt çka kishte mbetur nga babai ishte oda që shërbeu edhe për pritje kur vdiq, më 19 mars 1999, vetëm pesë ditë para bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe. Aty do të vinin liderë, hoxhallarë, njerëz të dijes, por edhe ballistë - miq të babait. Do të vinin të flisnin vetëm fjalë të mira, ashtu qysh flitet për të vdekurin. Por, kishte edhe të tillë që vinin të dëgjonin se çfarë do të ndodhte ditëve në vijim, në prag të luftës së përgjithshme në Kosovë.

Ishte kohë kur skenat për shqiptarët që masakroheshin ishin bërë të zakonshme. Ishte kohë kur Serbia kishte sjell në Kosovë paramilitarë të droguar, e që thikat i kishin hobi. Ishte kohë që të linte rrëfimin në gjysmë, apo ende pa e nxjerrë nga goja. Sepse, po të futeshin në oborr forcat serbe, do të iknim shpejt e shpejt, meqë serbët nuk bënin luftë, por pabesi e fëlliqësira.

Më 15 prill, kah 11, forcat serbe u futën në fshat. Lagjja ku jetoj unë nisi

të braktisej. Gra e fëmijë zunë të largoheshin me të shpejtë, ndërsa njëra prej autobllindave ndaloi mbi ne dhe e drejtoi tytën kah turma. Lotët për babanë ngrinë në fytyrat tona, e shtëpitë Zoti e di kur do t'i shihnim, apo nëse do i shihnim fare... Aty do linim varrin e babait, si roje dhe si një arsye më shumë për t'u kthyer në shtëpitë tona. Lamë shtëpitë, lamë varret, lamë gjithçka që kishim, por më të lumtur dukeshin të vdekurit, ashtu qysh kishte thënë dikush në odë se do

vinte koha t'u merrnin lakmi të vdekurve...

KUDO QË SHKOJ KTHEHEM TE VARRI I BABAIT...

Të martën që sapo iku, kalova pranë Kukësit. Gjatë "Rrugës së Kombit", në disa tela të vjetër, ishin renditur dallëndyshet.

Diçka më përsëritej në mendje dhe koka nuk gjeti fuqi mendore të ecte para pa e ndalur veturën. Do të ketë qenë ndonjë koincidence e ndonjë ëndrrë, e mendoja me vete.

Kur kisha shkuar në Kukës në fillim të muajit maj 1999, për ta kërkuar nënën me të cilën ishim ndarë pa e ditur drejtimin e njëri-tjetrit, në po ata tela i pata parë dallëndyshet e renditura, e që dukeshin sikur më përshëndesnin, duke më rritur shpresën se do ta gjeja nënën në "Kampin Italian 2".

Por, ato dallëndyshe tashmë mund të kenë ngordhur... Por, telat ndodheshin ende dhe dallëndyshet e reja kishin ardhur përsëri, për të qëndruar aty ku prindërit e tyre kishin qëndruar para 23 vjetësh.

Ndalova veturën aty ku uji rridhte dhe hodha shikimin andej stenës së lartë prej betoni, duke parë majat e pemëve dhe malit të pishnajës, ku dikur nuk kishte ekzistuar "Rruga e Kombit". Aty ishte një dalje për në fushën e kampeve të shumta, ku strehonin kosovarët e mi.

Lash veturën dhe u ngjita shkallëve për të dalë te vendi i ish-kampeve tona. Atëbotë, çadër më çadër... dhe arrita ta gjeja nënën time. Ishte e lodhur, e rraskapitur. E dërrmuar nga mërzia.

U gëzuam shumë kur u takuam. Asnjëri nuk mund të flisnim asnjë fjalë të vetme. Nëna më shtrëngoi fort, duke ma vënë kokën në kraharonin tim. Pastaj, për ta zbutur intrigën e lotëve, më tha se je bërë si lis...

Unë u bëra sikur qeshja, por më zuri me lot në sy.

"Kështu nuk e kemi bërë!", më tha.

Pastaj, më pyeti se kur do të kthehem në shtëpi...

"Së shpejti do të kthehem, nënë! Nuk do të kalojë as muaji dhe do të jemi atje, në shtëpinë tonë", ia

ktheva.

"Po, nëse e kanë djegur shtëpinë?!", më tha.

"E kemi varrin e babait...", i thash në vend të përgjigjes.

Gëzimi e përtëriu nënën. I kaluan dhimbjet, mundimet. Pastaj, u nisëm dhe arritëm në Shkodër, në një shtëpi të mirë...

U DESH TË SHKOJA NË KUKËS PËR TË NDJERË ERËN E NËNËS!

Nuk e dija nëse do të ktheheshim për një muaj, nëse do i gjenim "në këmbë" shtëpitë tona apo nëse nëna do kthehej e gjallë në shtëpi...

Dhe, tash, i futur në parkun e pishnajës së Kukësit dhe në mes mollëve të dikurshme, sikur e kisha nënën në përqaftim. E ndjeja peshën e saj në kraharonin tim. Më dukej se po ecja bashkë me nënën time, sikur po ktheheshim në shtëpi... E përjetova sërish erën e nënës... Dhe, te një trëndafil pranë mollëve, thash: "Oh, sa shumë më ke munguar nënë! Mu desh të vij në Kukës për ta ndjerë erën tënde!". Më dolën lotët. Në çast pranë meje kaloi një plakë dhe më pyeti se a ishte me mua çdo gjë në rregull, meqë m'i kishte parë lotët. I thash se po e kujtoja vitin 1999, kohë kur erdha për ta kërkuar nënën time në kampin e refugjatëve. Dhe, më kapluan kujtimet e asaj kohe...

Plaka, pasi më shikoi me keqardhje, vazhdoi rrugën e vet...

Prandaj, sado që shkruaj, nuk ngopem me kujtimet për nënën time në Kukës dhe për dallëndyshet e Kukësit që ma gjetën nënën...

HERË LOT E HERË GËZIM!

U kthyem në shtëpitë tona atë vit kur kishim më së shumti gëzim. E kishim pritur lirinë dhe shpresonim ta bënim shtetin tonë, për çka edhe kishim arsye të festonim. Festë gjithkrah dhe gëzim në çdo shtëpi. Më të kthyer në shtëpi, gjëja e parë që duhej bërë

ishte pastrimi i shtëpisë dhe i oborrit. Mora kosën ta kositja barin, meqë ishte rritur si kurrë më parë. E, nëse do kishte mina në oborr, unë do të vritesha i pari...

Tek nisa të kositja, në fqinjësi u dëgjua një shpërthim. Fqinji im kishte rënë në minë. Minën e kishin montuar duke e lidhur me rezën e derës së shtëpisë. Me të tërhequr rezën ajo kishte shpërthyer dhe u plagosën rëndë dy vetë, që ishin afër derës.

U gëzuam kur u pastrua oborri. Nuk u gjetën mina në oborrin tonë. Nuk ndodhi më asgjë e keqe...

Pas pak ditësh nisën të vinin motrat nga jashtë, me të dëgjuar që jemi kthyer. U bë shtëpia me lot e gëzim, vaj e aheng. Nëna dukej më mirë dhe ishim të gëzuar që shpëtoi në luftë. Motrat dhe nusja ime bënë ëmbëlsira për festën tonë të madhe – lirinë e shumëpritur. Bën aq shumë sa i mbahej mend edhe tash. Por, po atë ditë, fatkeqësisht, nëna pat sulm në zemër. Na mbetën ëmbëlsirat pa i ngrënë, mbi tavolina... Na mbeti kënga në buzë. Na mbeti çdo gjë në gjysmë. Gëzimi u shndërrua në hidhërim, sikur që hidhërimi dhe pikëllimi u bënë gëzime kur u nisëm nga Shkodra për në Kosovë.

Mbetëm të traumatizuar të gjithë. E humba besimin në çdo gjë të bukur. Nuk thonë kot: "Nis ëmbël, përfundon hidhët! Nis hidhët e mbaron ëmbël!". Dhe, nëse dikush të dërgon mesazh dashurie, pas tij mund të jetë një therrë e madhe, që të prek deri në asht...

S. Murturi





Ku mbeti ëndërrxhiu Agim Bahtiri?

Agim Bahtiri, dikur kryetar i Mitrovicës, lavdërohej se gjatë mandatit të tij do ta bashkojë Mitrovicën. Por, jo vetëm gjatë mandatit të parë, por as gjatë të dytit nuk arriti ta bëjë një gjë të tillë!

Normale do të ishte që Mitrovica të mos i ketë dy komuna, meqë nuk i ka as Prishtina, që, të paktën, është nja dy herë më e madhe se Mitrovica. Sidoqoftë, më Agim Bahtiri nuk është kryetar komune, por fjalët e tij se do ta bashkojë Mitrovicën jo që nuk u realizuan, por nuk mund t'i gjesh më as në gjithësi...

KOLONIZIM SI NË VITIN 1913!

Sidoqoftë, pjesa veriore e Mitrovicës, jo që nuk u bashkua, por në të u ndërtua "Lagjja e diellit" dhe lagje të tjera të pastra etnikisht serbe, për ta

kolonizuar Kosovën si shumë herë të tjera gjatë historisë... Sepse, kriminelët janë të pasinqertë. Edhe kur ndërtojnë "park të paqes", siç bën në Mitrovicë, ëndërrojnë të bëjnë mur për ndarje, pas të cilit do të kenë vend për t'u fshehur, që të vrasin këndej lumit Ibër shqiptarë dhe qytetarë të tjerë të Mitrovicës. Kriminelët nuk lejojnë të shkosh andej urës së lumit Ibër. Nuk lejojnë lëvizjen e shqiptarëve andej lumit. E mbajnë peng shtetin e Kosovës! Kanë rrahur sa e sa shqiptarë në pjesën Veriore të Mitrovicës...

Nuk i lejojnë shqiptarët të ndërtojnë shtëpi në oborret e veta në pjesën Veriore të Mitrovicës! I kanë kallë sa e sa herë pikat kufitare ndërmjet Kosovës e Serbisë! Mitrovicën e kanë shndërruar në kopje të Berlinit të dikurshëm gjermano-rus.

HË, KU JE TASH?

E, Agim Bahtiri, në fund të mandatit të dytë, u largua në heshtje, si fëmija kur bën faj... Hë, Agim Bahtiri, ç'thua tash për Mitrovicën?!

S.

Modele: Fahrije Zogaj

BOOM

Këngëtares që
e gjetën famën
në "talent shou"

Yjet shqiptarë
që lanë
dhimbje pas...

Të famshmet tona
me gjoks plastik

Fahrije Zogaj e Bujar Durmishi
mjeshtrit e muzikës live

Fahrije Zogaj e Bujar Durmishi

mjeshtërit e muzikës live



Nuk ka gjë më brilante sesa kur jeta të takon me dikë që është fiks për ty. Dhe, ky është rasti i Fahrije Zogajt e Bujar Durmishit, çift në jetë e në skenë. Dyshja krijojnë një nga çiftet e njohura të estradës shqiptare, që për vite me radhë sjellin bashkëpunime të bukura. Bujari nuk është vetëm këngëtar, por edhe një menaxher i shkëlqyer i të shoqes, këngëtares së mirënjohur Fahrije Zogaj, që njihet për një repertor të gjerë me këngë hite. Fahrija e Bujari janë ndër emrat më të angazhuar në mbrëmje, dasma e ahengje kudo në trojet shqiptare dhe në Diasporë.

BUJAR DURMISHI - NJË JETË ME KËNGËN

Bujar Durmishi e nisi karrierën muzikore në Ansamblin "Gurra e Kurbin", në qytetin e Laçit dhe gjithmonë u pikas për zërin e tij. Ka 30 vjet në skenë dhe i pandarë nga kënga e muzika.

Bujari ka marrë pjesë në shumë festivale dhe është fitues i disa çmimeve. Ai ishte pjesë e spektakleve të organizuara nga "Top Channel", "TV Klan", "E diela shqiptare" etj.

Dhe, ndonëse ka shumë këngë, ajo që e ka bërë të njohur është "Lenge e sevdasë", që është kom-

pozim i kompozitorit dhe mjeshtrit të madh Edi Balili, vizualizuar nga produksioni "Max Production".

Bujar Durmishi me bashkëshorten, njëkohësisht kolegen e tij më të mirë, Fahrije Zogajn, ka dy bashkëpunime, që janë pritur mirë nga publiku.

Ka deklaruar se të këndosh me Fahrijen është kënaqësi dhe, mbi të gjitha, përgjegjësi e madhe.

Çifti kohë më parë kanë lansuar dhe bashkëpunimin e radhës, këngën me titull "Kthehu zemër" dhe të tjera projekte në duo janë rrugës.



FAHRIJE ZOGAJ - YLLI I KËNGËS POPULLORE

Fahrije Zogaj nuk ka nevojë për prezantim të gjatë, meqë është zëri i veçantë i muzikës folklorike e popullore.

Këngëtarja prej shumë vitesh ka pushtuar zemrat e publikut shqiptar. Ajo këndon me shpirt dhe transmeton emocionet më të bukura përmes çdo tingulli.

Me një listë të gjatë këngësh dhe një karrierë të bujshme në muzikë, Fahrije Zogaj llogaritet të jetë një nga yjet e këngës në vend. Ka shumë

këngë të mrekulueshme, me autorë të cilët e kanë bërë më të mirën.

Kënga e saj me titull "Një komb, një flamur", është një nga hitet e mëdha të këngëtares, që edhe për të mbetët tejet e dashur dhe e veçantë. Këngëtarja njihet edhe për pamjen dhe stilin e një zonje të skenës. Këngëtarja, bashkë me të shoqin, Bujarin, duket se do ta kenë një verë të gjatë e të gjallë me angazhime, dasma e ahengje gjithandej Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë e Diasporës.

Nderim Neziri



Viteve të fundit u ndanë nga jeta shumë artistë të mëdhenj, e që kanë kontribuar në artin shqiptar dhe që do të mbesin gjithnjë në kujtimet tona.



ADEM MIKULLOVCI

Në vitin 2020 ndërroi jetë Adem Mikullovcu, në moshën 81-vjeçare. Mikullovcu la pas një numër të madh rolesh teatrale dhe projekte filmike.

Ndryshe, aktori me origjinë nga Mitrovica, ishte edhe delegat i Kuvendit të Kosovës në kohën e shpalljes së Deklaratës së 2 korrikut 1990, me të cilën Kosova është definuar si republikë, por edhe deputet në Kuvendin e Kosovës nga VV-ja.

Yjet shqiptarë që lanë dhimbje pas...



LEZE QENA

Në mars të vitit 2020 u shua një emër i madh i teatrit dhe filmit. Aktorja Leze Qena u nda nga jeta në moshën 85-vjeçare. Ajo do të mbahet mend për shfaqjet e panumërta në teatër dhe rolet e saj shumë të dashura në filmat dhe serialet vendore.



ISMET PEJA

Doajeni i muzikës shqipe, Ismet Peja, i mbylli sytë përgjithmonë në qytetin e Gjakovës në moshën 83-vjeçare.

Këngëtari Peja, me karrierë 60-vjeçare, la pas një repertuar të bujshëm të këngëve tradicionale shqiptare.



LURAN AHMETI

Aktori shqiptar nga Maqedonia, Luran Ahmeti, pas një beteje me Covid-19, ndërroi jetë më 25 mars 2021, në moshën 46-vjeçare, në Klinikën për Sëmundje Infektive në Shkup. Vdekja e aktorit të njohur i tronditi shqiptarët, por edhe artistët në Turqi.

Ahmeti luajti në një serë filmash në Turqi, si në “Lugina e Ujqërve” dhe seriali shumë i shikuar “Sulejmani i Madhërishëm”.



ISMET BOGUEVCI

Ismet Bogujevci ishte këngëtar i njohur, i cili identifikohet me muzikën popullore. Bogujevci ndërroi jetë më 13 maj 2021, në moshën 69 vjeç.

Dhe, duke lënë pas një karrierë me plot vlera, nisur nga viti 1972, nuk ndaloi së kënduari deri në ditët e fundit të jetës së tij.



RASIM THAÇI – CIMA

Humoristi i njohur, Rasim Thaçi-Cima, mbetet ndër figurat më të njohura të humorit shqiptar. Cima ishte njëri nga aktorët, i cili arriti t'i rezistojë kohës, viteve.

Cima ndërroi jetë në moshën 71-vjeçare nga infektimi me Covid-19, pas qëndrimit disa javësh në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë.



BURBUQE BERISHA

Lajmi për vdekjen e Burbuqe Berishës erdhi befasi dhe preku të gjithë shqiptarët. Ish-drejtoresha e Teatrit Kombëtar të Kosovës, Burbuqe Berisha, ka vdekur në vendin e saj të punës, në Ministrinë e Kulturës së Kosovës. Ndërroi jetë në moshën 51-vjeçare.

N. Neziri

Të famshmet tona me gjoks plastik

Jetojmë në kohën kur femrat e ekranit investojnë shumë për të pasur pamjen e ëndërruar. Dikush dëshiron vetulla më të ngritura, dikush hundë më të vogël, të tjera buzë apo mollëza më të fryra. Por, një nga preferencat më të zakonshme, ama edhe më të kushtueshme, është perfeksionimi i përmasave të gjoksit.

DAFINA ZEQRIRI

Ajo është përfolur se ka bërë ndërhyrje disa herë. Këngëtarja ka zgjedhur metodën e zhvendosjes së dhjamt nga një zonë të trupit për në gjoks dhe jo implantim të silikonit.



ROZA LATI

Ajo është ndër të paktat që e ka pranuar këtë ndërhyrje. Moderatorja, madje, postonte disa foto dhe video, bashkë me stafin kirurgjik dhe të tjera post-operacion.



VILDANE ZENELI

Modelja, përveç ndërhyrjeve të tjera në fytyrë, ka bërë ndërhyrje edhe në gjoks. Ajo nuk ngurron ta ekspozojë asetin e ri nëpër rrjetet sociale me ndjekësit e saj.



ZAJMINA VASJARI

Ish-misi shqiptar, gjithashtu, ka bërë ndërhyrje për të rritur volumin e gjoksit.



ÇILJETA XHILAGA

Në fakt, këngëtarja e ka bërë këtë ndërhyrje për ta zvogëluar numrin e gjoksit, ndryshe nga vajzat e tjera në këtë listë, për shkak të komplikimeve që kjo po i shkaktonte në shëndet.



ANA RUSTEMI

Prezantuesja, Ana Rustemi, e ka rritur për disa numra gjoksin, duke përfituar masën e dëshiruar. Ajo duket të jetë mjaft e kënaqur me pamjen e re, ndërkohë që kjo nuk është ndërhyrja e parë dhe e vetme që ka realizuar ndër vite.

D. H.

Këngëtarët që e gjetën famën në “talent shou”

Shumë të rinj të talentuar kanë qenë pjesëmarrës në “talent shou” të ndryshëm, duke pasur kështu mundësinë të bëhen pjesë e spektakleve televizive dhe ekranit.



Elvana Gjata



Elhaida Dani

SI IA DOLËN TË BËHEN YJE?

Edhe pse disa prej tyre nuk ja arritën që të shkonin në finalen e madhe, pjesëmarrja në ato programe talentesh u dha mundësinë të merrnin famë dhe të fitonin zemrat e publikut.

Elhaida Dani është një nga këngëtarët, e cila ka marrë pjesë në “Star Academy”, ku ka treguar talentin e saj në këngë dhe nga ajo kohë është bërë shumë e suksesshme.


Venera Lumani e ka marrë famën shumë më herët se të bëhej pjesë e “The Voice”. Këngëtarja vite më parë, gjithashtu, ka qenë pjesë e talent-shout “Star Academy” dhe ende vazhdon të jetë aktive në muzikë.

Filloreta Raçi, ose siç e njohim me emrin Fifi, ka qenë pjesë e audicioneve në “The Voice of Albania”. Përveçse këngëtare, Fifi njihet edhe për shkrimin e teksteve muzikore. Xhensila Myrtezaj është një nga këngëtarët që ka qenë, gjithashtu, pjesë e spektaklit të zbulimit të talenteve. Ajo ka qenë një ndër zërat më të pëlqyer në spektaklin “Ethet e së Premtes”.

Këngëtare tjetër, mjaft e njohur për publikun shqiptar, e që ka marrë famë në “Ethet e së Premtes” është edhe Elvana Gjata.

Gjithashtu, janë edhe Kamela Islamaj, Kejsi Tola, si dhe Vesa Luma.

Samanta Karavella ka qenë, po ashtu, pjesë e spektaklit “Ethet e së Premtes”. Edhe pse nuk arriti të shkonte deri në finale, Samanta shfaqti shumë talent në atë kohë dhe sot vazhdon të jetë shumë e suksesshme.



Filloreta Raçi



Samanta Karavella

N.



Lagjja Eliza

Rr. Hamdi Grajdevci,
Fushë Kosovë



Vendi ku fillon një jetë e re!

+383 49 50 90 90

www.cima-ks.com

Gjermani që luftoi në Kosovë, tash në Ukrainë!

Djaloshi gjerman, që më 1998-1999 ngriti moralin e luftës së UÇK-së në Kosovë, vuajti 12 vjet burg në Istog. Prindërit dhe motrat gjatë asaj kohe i ka pasur në Gjermani. U dënua me 20 vjet heqje lirie për një vepër që nuk e ka bërë - hedhja në ajër e autobusëve me serbë në Merdare paslufte, kur rifilloi lëvizja e serbëve nga Kosova për në Serbi dhe anasjelltas.



Roland Bartetzko, në kohën kur e bëmë bisedën, ishte 41 vjeç. Vuante dënimin 20 vjet heqje lirie. Megjithatë, i ka kaluar më shumë se 11 vjet burg në Istog, pa dal jashtë telave të burgut.

Roland Bartetzko ka studiuar në Fakultetin Juridik të Universitetit "Fama" në Mitrovicë, qindra metra larg nga Mitrovica Veriore, ku ishte në luftën e UÇK-së për lirinë e Kosovës.

Në UÇK njihej me nofkën "Shabani", që e kishte marrë me të hyrë në UÇK, kur e kishin emëruar dy njerëzit që kishin bërë kontaktin e parë ta njoftonin me eprorin e vet, Bekim Shytin.

Xhevahir Geci dhe Nexhati, e kishin emëruar me nofkën "Shabani", që edhe sot njihet në Universitetin "Fama" me po atë emër, por edhe në jetën dhe realitetin kosovar.

E njohin të gjithë burrin me pamje të një heroi që vjen sikur nga filmat aksion. "Shabani" dy herë ishte plagosur në luftë, por as nuk e bën të madhe që është dënuar me 20 vjet burg.

Në pyetjen: "Sa të kanë dënuar?", gjakftohtë përgjigjet: "20 vjet më ka dënuar UNMIK-u! 12 i kam mbajtur dhe kam edhe tetë të tjera për t'i mbajtur".

Në luftë kishte ardhur nga Aheni i Gjermanisë, afër Kelnit dhe kishte luftuar për forcat kroate në Bosnjë dhe Hercegovinë kundër serbëve dhe më pas, me të plasur lufta në Kosovë, kishte ardhur në UÇK, për të luftuar kundër serbëve.

Ishte ushtar profesional gjerman. I kishte kaluar në armatën gjermane katër vjet. Dhe, me daljen prej saj ishte bërë sërish

ushtar në frontin e luftimeve.

Flet mrekullisht gjuhën shqipe dhe komunikon shqip. I heshtur dhe me një trup atletik, me gjoks të qitur dhe me pamje si të Rambos, "Shabani", në kohën teksa priste të hynte në provim në lëndën e Statistikës, me çantë në krah, me ta parë revistën "Kosovarja" në duart e ekipit, u afrua dhe na përshëndeti dhe fill pas përshëndetjes bëmë një bisedë të gjatë me të...

I çmuar në mesin e shqiptarëve, "Shabani" thotë se Kosova po shkon në drejtim të duhur edhe si shtet, por edhe me FSK-në. E, sa i përket Kosovës Veriore thotë se bashkësia ndërkombëtare nuk po do të bëjë më shumë për ta bashkuar këtë pjesë të Kosovës.

HISTORIKU I "SHABANIT"

Duke treguar inkuadrimin e tij në UÇK, Roland Bartetzko, thotë:

"Erdha në Kosovë nga Kroacia, ku kisha luftuar në krah të forcave kroate kundër serbëve. Nëse bëjmë një krahasim mes luftës në Kroaci dhe asaj në Kosovë, në Kroaci luftën e udhëhiqte shteti, ndërsa në Kosovë nuk kishte atëherë shtet.

Në Kroaci, krah kroatëve, kishte shumë të tjerë që luftonin, si gjermanë, shqiptarë e të tjerë, që i nënshtroheshin shtetit që mbante përgjegjësi.

E, në Kosovë ishte krejt ndryshe, sepse këtu nuk e bënte luftën shteti, por ana morale e popullit.

Kur erdha fillimisht në Kosovë, pata kontaktin me Xhevahir Gecin dhe me Nexhatin, që më ofruan me Bekim Shytin.

Në Gjermani kisha qenë nënoficer para-shutist dhe isha një ushtar i përgatitur për luftë dhe për përdorim armësh. Në

Gjermani kam babanë dhe dy motra, të cilët vijnë dhe më vizitojnë në Kosovë. E kam gruan shqiptare në Prishtinë, me të cilën jemi njohur në vitin 1999.

SI U RENDIT NË RADHËT E UÇK-SË?

“Për Kosovën kisha mësuar qysh në Bosnjë e Hercegovinë. Atje pata vendosur që nëse mbetesh gjallë të vija këtu.

Me të ardhur në Kosovë, mësyva Drenicën, në vitin 1998 dhe takova Xhevahirin.

Rreshtimi në Njësitin special nënkuptonte shumë detyra që UÇK nuk mund t’i merrte përsipër.

Kemi bërë shumë aksione të rrufeshme me ushtarë të UÇK-së në këtë njësit dhe kemi qenë ushtarë të vërtetë me virtytë të larta dhe me orar strikt disiplinor dhe me përgjegjësi në hierarkinë komanduese. Kemi pasur për detyrë të futemi aty ku nuk mund të futej askush tjetër dhe kemi arritur që shumëçka të bëjmë në kuadër të UÇK-së, por kemi pasur edhe momente që nuk kemi mundur ta zbatojmë misionin, për hir të popullatës që ishte në ekspozim të rreziqeve nga forcat serbe”, tregon “Shabani” dhe shton:

“Komunikimi im ishte shumë i mirë, posaçërisht me Bekim Shytin, i cili e njihte mirë anglishten.

Me ardhjen time në UÇK, u krijua shumë besim në mesin e ushtarëve, sepse moralisht kjo gjë tregonte se ne e fitonim luftën dhe se ajo ishte e drejtë dhe për liri”.

“SHABANI” KA STATUTIN E INVALIDIT TË LUFTËS SË UÇK-SË

Dy herë i plagosur në front, “Shabani” aktualisht ka statutin e invalidit të UÇK-së. Ai i ka marrë dy plagë në front, një herë i plagosur mjaft rëndë dhe një herë paksa më lehtë.

“Një herë jam plagosur rëndë dhe kam qëndruar për shumë ditë pa mundësi të ecjes, kurse një herë jam plagosur më lehtë dhe i kam hequr vetë pjesët e granatës që më ishin ngulur në turp”, tregon aktet e plagosjes Rolandi dhe vazhdon:

“Për mua ky statut ka shumë rëndësi dhe e konsideroj vlerë të madhe, por do ta

konsideroja edhe më të vlefshëm nëse invaliditeti do t’u takonte vetëm ushtarëve që kanë luftuar, e jo edhe atyre që nuk kanë luftuar në UÇK.

Këtë statut e kanë marrë edhe disa që nuk kanë luftuar e as nuk kanë qenë fare në UÇK dhe kjo, ndoshta, e zbehtë këtë akt të madh, që ka domethënie të jashtëzakonshme morale.

Unë që nuk merrem me politikë, shoh se ushtarakisht Kosova po shkon në drejtim të mirë, të duhur dhe një ditë nuk do mend se do të ketë një ushtri të fortë në kuadër të NATO-s, të aftë të operojë konform nevojave që ka Kosova.

I gëzohem ecjes para të shtetit të Kosovës, sepse në Gjermani do të shkoj pas lirim të burgjeve si turist. I kam normal të gjitha të drejtat e shtetasit gjerman, por unë do të jetoj në Kosovë dhe do të jem shtetas kosovar.

Ajo që më bën të ndjej këtë nevojë është se më nderojnë shumë, kudo që jam dhe kudo që hyj e dal. Më njohin dhe kjo famë personale më bën të kem më shumë përgjegjësi ndaj shqiptarëve, bujarinë e të cilëve e çmoj tej mase.

Kam filluar të dal nga pak për punët e mia, si profesionale dhe jetësore dhe me autorizime të veçanta i kryej obligimet dhe kthehem në burg, në Istog, ku do i kaloj edhe tetë vite që më kanë mbetur”.

“MË KANË DËNUAR PA FAJ 20 VJET BURG!”

“Shabani”, e që nuk e bën të madhe dënimin me 20 vjet burg, konsideron se dënimi është bërë në mënyrë politike, sa për ta mbuluar një ngjarje të ndodhur në Merdare, kur UNMIK-u, sipas tij, duhej ta dënonte dikë për atë vepër! Dhe, duke e komentuar dënimin dhe pafajësinë, “Shabani” thotë:

“Jam dënuar pa prova. Dënimi pa prova do të thotë se nuk jam fajtor për asgjë lidhur me atë ngjarje. Ishte një pozitë në të cilën shteti gjerman nuk kishte të drejtë të ndërhynte dhe këtë edhe ma thanë pikërisht kështu. Por, edhe unë e konsideroj këtë gjë si një dënim që u janë bërë shumë shqiptarëve që mbahen në burgje pa arsye, vetëm e vetëm pse dikush u është frikësuar atyre.

Unë i kam provuar të gjitha mundësitë ligjore për t’u liruar, por nuk ka funksionuar asgjë. Më kanë dënuar me 20 vjet burg, por rasti im ka qenë tërësisht rast politik. Në fakt, mund të them se janë nxituar të më shpallin fajtor, por lënda dhe rasti im janë edhe në Strasburg të proceduara. Unë nuk kam dëshirë të flas shumë për dënimin tim, sepse po shkojnë vitet dhe tash më shumë dëshiroj t’i falënderoj stafin menaxhues të Universitetit “Fama”, Salal Ahmet Xhekën, që m’i ka mundë-



suar studimet bashkë me drejtorin Ylber Durmishin.

Po e përmbylli vitin e parë të studimeve dhe këtë e kam për nder. Po aftësohem profesionalisht.

Pa mëdyshje, kam miq nga shqiptarët dhe e di se më duan shumë. Por, edhe Kosova ka obligime ndaj meje, sepse dënimi im nuk është personal, por i takon edhe shtetit të Kosovës kjo përgjegjësi.

Unë në burg nuk jam për punë private dhe as burgun nuk po e vuaj për punë private, por, në fakt, këto interesa janë shumë më të gjëra”, deklaroi ai.

POPULLI SHQIPTAR ËSHTË I MIRË

“Shabani” lavdëron shqiptarët si popull, sepse dinë ta nderojnë njeriun, aq më shumë atë që vjen nga jashtë.

“Shqiptarët duhet të mësohen të bëjnë shtetin dhe jo të sillen si një shoqëri ku gjërat funksionojnë privatisht. Duhet të dinë ta nderojnë dhe respektojnë ligjin”, thotë ai.

Rolandi thotë se me Mitrovicën Veriore nuk po do të merret bashkësia ndërkom-bëtare, sepse, po të donte ajo, këtë problem do ta rregullonte shumë shpejt.

Mitrovica Veriore është problem politik. Ajo nuk mund të integrohet në shtetësi të Kosovës pa pasur një plan dhe një strategji dalëse nga kjo situatë.

“Unë di një gjë: Serbët nuk mund të tolerohen andej Ibrit të bëjnë çka duan vetë. BE-ja u ka dhënë atyre këtë mundësi dhe ajo e ka toleruar këtë situatë”, thotë me bindje “Shabani”, në fund të bisedës sonë.

“SHABANI” EDHE NË UKRAINË...

“Shabani” kohë më parë ka botuar librin me titull “Frymë lufte”, i cili është pritur mirë nga lexuesit.

Sidoqoftë, ditë më parë, në mjetet tona të informimit, lexova se thirrjes për luftë në Ukrainë i është përgjigjur edhe “Shabani” dhe dashtë Zoti edhe atje të jetë fitimtar!

Safet Krivaça



Vasiliqia Kontakciu, njihet si femra më e bukur dhe më besnike shqiptare, që ka njohur ndonjëherë historia. Ajo i qëndroi besnike Ali Pashë Tepelenës, ndonëse moshat e tyre kishin dallime hiç më pak se gjashtëdhjetë vjet.

Ali Pashë Tepelena ishte 74 vjeç kur njohu Vasiliqen, 18 vjeçe. Plaku Tepelenë u martua në moshën shtatëdhjetë e katër vjeç me Vasiliqen. Ata u bënë dashnorët më të përmotshëm, para të cilëve nuk do të vlejë asnjë dashuri tjetër, e as interesi.

Vasiliqia e bukur, thjesht, u bë ilaçi i Ali Pashë Tepelenës dhe e mbajti në formë me forcën madhështore prej sundimtari. Sidoqoftë, një figurë e ndritur e historisë shqiptare nga Janina, reflekton sot e asaj dite një qëndrim shumë të veçantë në këndin e dashurisë.

Përkundër burrërisë së rëndë të Ali Pashë Tepelenës dhe moshës së tij shtatëdhjetë e katër vjeç kur njohu Vasiliqen, me bukuri të mahnitshme, lidhja e tyre mbijetoi deri te krijimi i këngëve që këndohen ende me krenari si, bie fjala, kënga "24 pashallarë".

BUKURI E RRALLË SI VASILIQIA...

Vasiliqia Kontakciu njihet si figura që turbulloi mendjen e Pashait, në një moment tepër të rëndësishëm historik, kur ai qëronte llogaritë me falsifikatorët e parave të Plishvicës, që ishte një periudhë kohe tepër e ndjeshme për nomenklaturën e Ali Pashës.

Ajo që është me rëndësi në këtë storie të martesës së Ali Pashës në këtë moshë, të gjithë historiografët që janë marrë me këtë ngjarje, e kanë pasur më shumë temë Vasiliqen, sesa Ali Pashë Tepelenën.

Pse ndodhi kjo?

Vasiliqia, ishte femra më e bukur e kohës. E tillë trajtohet edhe tash. Portreti i femrës së bukur shqiptare, e cila sipas përshkrimeve, mund të shpallet më e bukura e trojeve shqiptare, ka tërhequr vëmendjen e analistëve, jo vetëm për bukuri, por edhe për një virtyt tepër të shenjtë njerëzor, me të cilën dëshmonen shqiptarët, e ajo është besa dhe besnikëria e gruas ndaj burrit. Vasiliqia ishte femër e bukur, që bëri kar-



Si u martua Tepelena 74 vjeç me Vasiliqen 18 vjeçe?

rierë mençurie, duke qenë në një pozicion tepër të vështirë:

Një, në mes Janinës, e dy, në mes Portës së Lartë të Stambollit.

Kjo veçanti e një dashurie të padëgjuar për nga ndjenja e zemrës dhe shpirtit që lindi mes Ali Pashë Tepelenës, shtatëdhjetë e katër vjeç dhe Vasiliqes tetëmbëdhjetë vjeçe, është fenomen.

Të gjithë ata që kanë skicuar këtë portret të rëndë, nuk kanë mundur të mos ndalen në hulumtimin dhe enigmën Pasha-Vasiliqia, që i qëndroi besnik njeriut të parë të dashurisë së saj, Ali Pashë Tepelenës. Në këtë skicim-zbërthim të personalitetit, më shumë doli të kishte rëndësi Vasiliqia, sesa vetë Ali Pasha.

SI U NJOHË ALI PASHË TEPELENA ME VASILIQIEN?

Një takim mahnitës, e kishte befasuar Ali Pashën në moshë të shtyrë, kur mbeti i magjepsur me bukuroshen që kurrë më parë nuk e kishte parë. Ajo ishte Vasiliqie Kontakciu.

Takimi ndodhi në mesin e logut të bal-lafaqimit të ushtarëve të pashait dhe manipuluesve të parave që po i falsifikonin ato në fshatin Plishivicë. Pashai i vë flakën fshatit. Vasiliqia, me bukurinë mahnitëse, i ra në gjunjë pashait, duke kërkuar mbrojtje nga sulmuesit.

Pashait iu fut turbullira në kokë dhe e ngriti në këmbë vogëlushen dhe, pasi e shtrëngoi në gjoks, i tha:

"Mund të jeni drejtuar gabimisht, sepse pikërisht unë jam veziri i keq dhe i urryer, që i vura flakën fshatit!"

Sidoqoftë, pashai ia dha besën asaj se do ta mbronte dhe se ajo do të ishte pjesë e pallatit të tij mbretëror.

Dhe, kur ajo i mbushi të tetëmbëdhjetat, u bë me të drejta të plota të shpallej sekretare dhe gruaja e tij e përjetshme.

Por, një raport i tillë, me një distancë moshe, askujt nuk i bënte përshtypje. Nuk ishte e imagjinueshme që ajo me një moshë të tillë të bëhej edhe gruaja me besnike në jetë, duke i qëndruar pranë Ali Pashë Tepelenës.

Përkitazi, ajo do të bëhej gruaja më e bukur shqiptare, për të cilën do të shfaqte kureshtje dhe interesim edhe Stambolli dhe qarqet zyrtare të Portës së Lartë.

KUR U BË MARTESA E ALI PASHË TEPELENËS ME VASILIQIEN?

Martesa e tyre u bë më 5 prill 1816. Pas një kohe Vasiliqian Ali Pasha e emëroi sekretare të mbretërisë. Nga dashuria dhe respekti për të, Ali Pasha i ofroi Vasiliqies edhe mundësinë ta ndërronte fenë.

"Jo, sepse një grua që heqë dorë nga perëndia e saj, nuk mund të jetë besnike e një perëndie tjetër!", ia kthen ajo.

Sidoqoftë, Vasiliqia i qëndronte gjithmonë te koka burrit të saj më të vjetër deri në vdekje...

Dhe, sipas njohësve të jetës sekrete, thuhej se Vasiliqia ishte ilaçi i Ali Pashës dhe i shërbente atij edhe për shëndet të mirë.

Por, pas vdekjes së pashait, komanda turke urdhëroi që Vasiliqia e bukur të depërtohej në Stamboll. Dhe, nuk e ekzekutuan shkaku i bukurisë mahnitëse.



Si u martova me burrin që e pash vetëm në fotografi?



Mezi e kam përballuar shpirtërisht dhe fizikisht gjithë atë që më ndodhi në ditët e para të martesës sime, ditë kur pash haptazi se ma kishin ndërruar burrin! Nuk ishte ai që e kisha parë në fotografi...

Në rrethinën ku jetoja unë, në një fshat të Dukagjinit, ishim shumë femra që kishim mbetur pa u martuar, meqë djemtë në vitet 90 masovikisht ia mësyn Perëndimit. Në atë kohë me të madhe e lëshonin Kosovën, kinse për të gjetur fat më të mirë... E ne, femrat e harruara, shkaku i virtyteve të larta mbetëm në shtëpitë tona, duke pritur të gjenim fatin tonë. Pasi i kisha mbushur 28 vjet dhe e kisha kryer që moti shkollën e mesme, mbi të gjitha, pasi nuk kisha "gabuar" deri atëherë, pavarësisht se kishte kohë që unë jetoja në Prishtinë te vëllai im, një ditë takova një ish-shok të shkollës së mesme, me të cilin pime nga një kafe. Ai kishte disa vjet që po jetonte në Gjermani dhe e kishte gjetur me kohë fatin e vet me një gjermane, e që ishte penduar shumë shkaku se martesë e tij ishte bërë me kushte, e që atij ia mundësonin mar-

rjen e leje qëndrimit në Gjermani. Më tha se e kishte një shok, moshatar tonin, i cili ishte me leje të përhershme qëndrimi në Gjermani dhe kishte dëshirë të njëhej me një shqiptare për qëllime martesore.

SI U NJOHA ME "GJERMANIN"?

Ai aso kohe s'kishte mundësi të vinte në Kosovë, sepse, sipas tij, e kërkonte policia serbe. Por, njohja jonë do të bëhej, kryesisht, me anë të fotografive që do ia dërgonim njëri-tjetrit nëpërmjet shokut tonë, thënë shkurt, mesitit tonë.

Dhe, unë menjëherë ia dhashë shokut tim një album me fotografi të miat, që nga moshë më e re e deri në ditët e atëhershme...

Ndërkaq, ai, i zgjedhuri im, do t'i dërgonte fotografitë e veta nëpërmjet një agjencie turistike të Pejës, autobusët e së cilës agjenci në atë kohë shkonin e vinin me të madhe, shkaku i shkuarjes së të rinjve tanë në Perëndim. Por, jo dhe vetëm i të rinjve...

Ashtu edhe ndodhi. Shumë shpejt i mora fotografitë e pritura me padurim, të cilat, pa dyshim, mund t'i pëlqenin secilës femër. Në fotot që mora shihej një mashkull i bukur, xhentëlmën, tamam top-model. Ambienti ishte një vend i bukur, që të jepte të kuptosh se ai jetonte në kushte të mira jetese, se kishte standard të

lartë jetësor, e që ishte një bazë e mirë për jetë të ardhshme martesore...

Vumë edhe kontaktet e para me telefon dhe pas disa ditësh arritëm të biem dakord që të bëjmë fejesën, edhe pse nuk ishim parë asnjëherë, por vetëm duke i shikuar fotot e njëri-tjetrit dhe duke ia dëgjuar zërin njëri-tjetrit në telefon. Por, unë kurrë nuk e kisha ëndërruar e as imagjinuar një gjë të tillë...

Madje, ç'ishte edhe më befasuese, nëpërmjet një të njohshmi të tij që kishte ardhur nga Gjermania ma kishte dërguar garancionin, me të cilin do të paraqitesha në ambasadën gjermane për vizë, i cili garancion, sipas tij, do ma mundësoj pa kurrfarë problemi marrjen e vizës.

Megjithatë, askush nga familjarët e mi nuk befasohej me një gjë të tillë, sepse koha ishte e tillë...

DHËNDRI S'ISHTE AI I FOTOGRAFISË!

Në Mynhen do më priste shoku im, mesiti ynë, posa unë të zbrisja nga autobusi dhe do më dërgonte në banesën e tij, në të cilën banesë pastaj do të vinte dhëndri dhe më merrte nuse...

Posa zbrita nga autobusi kisha bindjen se punët po shkonin sipas planit dhe marrëveshjes. Pas dy ditësh që arrita në Gjermani ishte e diel, ditë kur edhe do vinte dhëndri me veturë e do

më merrte nuse. Erdhi vetë i treti... Më morën e më dërguan në një periferi të qytetit, por edhe atje ishte bukur... Në mbrëmje të gjithë shkuan e unë mbeta vetëm me dhëndrin. Nuk ishte ai i fotografisë dhe asgjë të përbashkët nuk kishte me fotografitë që i kisha shikuar me qindra herë... U befasova aq shumë sa as nuk mund të flisja. Mbetëm vetëm unë e ai në dhomë... Unë ende isha e veshur me fustanin e nusërisë që ma ofroi shoku im para se të vinte të më merrte dhëndëri, por mërzia dhe dëshpërimi më kishin kapluar tërësisht. "A është e mundur t'më tradhtoj shoku im?!", e solla në mendje. I "zgjedhuri" im m'u afrua afër dhe filloi t'ma shpërthekoj fustanin e nusërisë, kurse unë e shikoja e habitur. Në çast mendova t'i them jo... Në atë luftë timen me vetveten, ai m'i hoqi ngadalë rrobat, më shtriu në shtrat dhe mbi mua provoi forcën e jo dashurinë... Mezi e përballova... E luta t'më tregonte sinqerisht pse e kishin bërë atë inskenim me fotografi të dikujt tjetër. Ai u tregua i drejtë dhe më tha: "Fotot që t'i kam dërguar nuk kanë të bëjnë asgjë me mua, sepse unë jam tjetër njeri, siç po e vëren edhe vetë, sepse kam pasur nevojë për femër, për grua". Ajo natë kaloi si kaloi... Nuk ma donte shpirti atë njeri, ani pse tash më bëri grua të tij...

BURRI IM MË TRADHTOI, POR EDHE UNË E TRADHTOVA!

Vinin mysafirë kryesisht në mbrëmje. Unë u shërbeja pa pritesë, sepse kështu isha e edukuar në familjen time, në Dukagjinin tim, që mysafirët t'i prisnim si e më mirë. Një mbrëmje "im burrë" solli në banesë një shok të vetin, me të cilin më tha se ka kohë që punojnë bashkë. Qëllimi i mysafirit, siç tha im burrë, ishte të shihte se kënd kishte marrë për grua... Thënë shkurt, ishte paksa më i ri se im burrë, por shumë më i pashëm dhe sikur më bëri për vete që në shikim të parë... Më mbetën sytë në të... U bëra darkë dhe pastaj edhe çaj. Pas një kohe ai u ngrit që të shkonte. Ia

dhashë dorën dhe ia shtrëngova pak, por jo edhe shumë, sepse u frikësova se mos do e hetoj ai, im burrë. Dhe, prej asaj nate ai filloi të vinte te ne, së paku dy herë në javë. Ndërkohë, gjërat filluan të vijnë në vend të vet: pas dy muajsh tim burrë kompania e dërgoi një javë në një vend tjetër, e që nuk kishte mundësi të kthehej në mbrëmje shkaku i largësisë së madhe. Një mbrëmje në derën e banesës sime u dëgjua zili. Kur shikova në vrimën prej qelqi pash se ishte ai, shoku i burrit tim. T'ia hapja derën a jo, e solla në mendje. Dhe, teksa unë hamendesha se ç'të bëja, ai i ra edhe një herë ziles. Nuk u hamenda më dhe e hapa derën. Më përshëndeti me një buzëqeshje të lehtë. Dhe, pa një e pa dy u kthye në krah dhe përbiroi brenda. U ul në kolltukun ku ulej gjithmonë e unë i bëra kafe. Më tha se e dinte që nuk e kisha burrin në banesë dhe se ai ndodhej nga 100 kilometra larg nesh. Kjo edhe ishte arsyeja pse ai këtë herë kishte ardhur te ne... Me kafën përpara u ula edhe unë afër tij dhe biseduam gjerë e gjatë, pa u ngutur fare. Ndërkohë, ai u afrua edhe

më afër meje dhe njërin dorë ma vuri mbi këmbën time. Thënë të drejtën, edhe pse që në takimin e parë kisha ndier nevojë për të, tash, kur më erdhi rasti, disi u stepa... Por, kur e ofrova dorën që t'ia merrja filxhanin e kafes, sepse kishte kohë që e kishte pirë kafën, ma mori dorën dhe ma puthi. Të dridhura ma përshkruan trupin... Dhe, kur vërejti se unë humba tërësisht, më rroku për beli dhe më shtrëngoi fort e fort, aq sa iu dorëzova tërësisht... Në shtratin tim të fjetjes të dy trupat tanë u bënë një... Pastaj, bëmë atë që bëhet në ato momente... Dhe, përjetova gjithë atë që kisha ëndërruar se do e bëja me tim burrë derisa isha në Kosovë, në pritje për t'u bërë nuse... Pas dy vjetësh, me marrëveshjen e tij, e lash burrin dhe u martova për të. Për çudi, im burrë i deriatëhershëm nuk reagoi edhe aq, ndoshta nga fakti se e dinte se nuk e doja, se më kishte tradhtuar... Sikur e brente ndërgjegjja për tradhtinë që ma kishte bërë...

Rifadije S.



*84-vjeçarja nga Lladroci, që e ka lënë
amanet ta përcjellin në varr me def!*

Pa diplomë s'ka punë, me diplomë s'ka punë!

Të gjithë ëndërrojnë më të mirën për veten e tyre dhe duan që në një të ardhme të kenë një profesion, i cili do t'u mundësojë të ardhura të mjaftueshme dhe kënaqësi profesionale. Ç'thonë maturantët e anketuar në këtë temë?

SH. DEMIRI, MATURANT NË SHKOLLËN EKONOMIKE: DO I RREKEM NDONJË ZANATI!

- Posa ta kryej shkollimin ku jam tash, do të shkoj servis më servis për të kërkuar t'më pranojnë të mësoj zanatin e automekanikut, sepse shkollimi ku tashmë jam maturant, në shkollën ekonomike në Prishtinë, nuk më jep mundësinë të gjej një vend pune.

Më s'ka punë në administratë. Është mbushur me të tillë, madje ka edhe pa nevojë.

Më pëlqen të vishem me veshje sportive dhe me rroba të errëta, e duart t'i kem me njolla nga vaji i veturave. Nuk mërzitem aspak që duart apo rrobat mund t'i kem me ndonjë shenjë.

Tek e fundit, unë jam lindur e rritur në fshat, ku gjithmonë kemi pasur bagëti dhe është dashur të kujdesem për to.

Andaj, pas kryerjes së shkollës së mesme, nuk kam dëshirë t'i vazhdoj studimet, sepse kam parë nga vëllai im, i cili ka diplomuar në Fakultetin Juridik që tre vjet dhe rri i papunë në shtëpi, se diploma më nuk ka vlerë.

Edhe prindërit e mi mendojnë njëjtë si unë: për tregun e sotëm të punës më shumë vlen një zanat sesa një diplomë. E di që të bëhesh mekanik do t'i kesh duart gjithmonë të ndotura, por ama është një punë që paguhet mirë...



V. GASHI, MATURANT NË SHKOLLËN TEKNIKE: NUK BRENGOSEM NËSE NUK PRANOHEM NË FAKULTET!

- Nuk do të ndihem keq edhe po të mos pranohej në fakultet, meqë ende nuk jam përcaktuar as ku do të konkurroj, sepse kam parë shumë të rinj që, megjithëse mbarojnë Juridikun a Ekonomikun punojnë kamerier.

Ndërsa, unë kam ambicie që me një apo dy vjet "shëgert" një një servis veturash, të hap pastaj një biznes të vogël, ku të punoj vetë.

Jetoj në familje prej 6 anëtarësh: me prindër, vëllanë dhe dy motra. Nga të gjithë ata vetëm motra e madhe është e punësuar si mësuese. Pjesa tjetër e familjes është pa punë.

DH. KRASNIQI, MATURANTE NË GJIMNAZ: DIPLOMA NUK MË NDIHMON TË GJEJ PUNË!

- Jam në gjimnaz dhe e di se pas kryerjes së shkollës së mesme s'kam për të gjetur një vend pune. Një ditë një shoqe imja më sugjeroi të interesohem të gjej një vend pune në një nga sallonet tanë të bukurisë në Prishtinë.

Dhe, pas trokitjes "derë më derë", siç thuhet në popull, gjeta një vend pune pas orarit të mësimt në njërin nga sallonet e bukurisë dhe kam filluar të shkoj pasdite në praktikë, sepse para dite jam në shkollë, meqë edhe pak ditë kanë mbetur deri në përfundim të shkollimit të mesëm.

Një gjë që më pëlqen në sallonin ku jam është praktika. Atë që ti mëson edhe e praktikon.

Sipas meje, orientimi i të rinjve për të mbaruar me patjetër një fakultet, është i gabuar, sepse çdo vit dalin me mijëra studentë që nuk gjejnë vende pune, meqë tregu ynë kosovar është ngopur me juristë, ekonomistë, arkitektë, inxhinierë, mjekë, mësues, infermierë etj.

Unë për veten time e quaj vendim të gabuar atë që kam marrë kur u përcaktova në gjimnaz. Po ta ktheja kohën, nuk do zgjidhja më këtë orientim, i cili sot nuk më ofron kurrfarë vendi pune. Jam regjistruar me kënaqësi aty, por kjo nuk më ndihmon fare në tregun e punës!

FJALË PËR FUND

Sidoqoftë, shkollimi i nevojitet gjithsecilit dhe pa shkollim nuk ka as dije, e as zanat. Nuk thonë kot: Më mirë me shkollë se pa shkollë.

E, për krijimin e vendeve të reja të punës është punë e Qeverisë dhe e politikanëve, e jo të mendojnë si të vjedhin e të pasurohen, e të rinjtë të bredhin rrugëve...

D. H.



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritet që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksessit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq

të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjamit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epiderme), duke shpërbë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjamit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjamin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qulltet trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

Pse dua të martohem me dy burra?

Në zemrën time kanë hyrë dy burra, për të cilët vuaj natë e ditë... Kur dal me njërin mendja më rri te tjetri. Kur puthem me njërin më kap etja për tjetrin... E, kur jam në shtëpi mendja më rri te të dy...

SI NISI "LOJA" ME TË PARIN?

Nuk po mund ta marr me mend çfarë jam duke bërë, e që jam në lidhje të pandashme me dy meshkuj dhe të kem emocione të njëjta për të dy...

Dhe, sa e sa herë i bëj pyetje vetes: A ka vajzë tjetër që i do dy meshkuj si unë? Por, si nisi lidhja ime me njërin e si me tjetrin?

Një ditë vëllai im më tha se një shoqe e tij e kishte babanë pronar të një market të njohur në Prishtinë, së cilit nuk po ia përmendi emrin. Më tha se kishin nevojë për punëtore.

U gëzova shumë, vetëm e vetëm që të dilja nga burgu shtëpiak, sepse kishte kohë që e kisha kryer shkollën e mesme dhe punë nuk gjeja dot. Në anën tjetër, thashë, do më hapen edhe rrugët e fatit...

Dhe, ashtu ndodhi, sepse që në muajin e parë të punës në lokalin tonë vinte vazhdimisht një djalë, që e njihte shefin im. Ai ba-

nonte në ndërtesën përballë marketit tonë. Ai, sa herë vinte ta takonte shefin tim, së pari më përshëndeste. Dhe, me kohë filloi edhe t'më pëlqej, sepse ishte i lezetshëm, komunikativ.

Por, të dyve na mundonte e njëjta gjë: nuk gjenim mënyrën se cili t'ia shprehim i pari dashurinë...

Një ditë erdhi dy herë në ditë. Më tha: Ndoshta e kupton qëllimin e ardhjes sime... Dhe, pas pak, më tha troç: "Unë më shumë po vij për ty!"

U shtanga, ani pse e prisja një gjë të tillë... Dhe, nga ajo ditë pas çdo orari të punës fillova të shkoja në banesën e tij, e që ndodhej përball marketit tonë...

Thënë shkurt, që në ndejën e parë në banesën e tij kërkoi të bënim seks, por unë, meqë isha e virgjër, i thashë se një gjë të tillë mund ta bëjmë vetëm kur të fejohemi... Kjo bëri që ai edhe filloi t'i rralonte ardhjet në marketin ku punoja, e unë vuaja për të...

NJOHJA ME TË DYTIN...

Dhe, derisa Astriti i rralloi ardhjet në market, në jetën time filloi të zë vend edhe një djalosh tjetër, Arti, i cili filloi dalëngadalë të depërtojë në thellësitë e zemrës sime. Por, edhe pse fillova ta dashuroja, nuk jepesha pas tij, sepse Astritin, pra të parin, ende e mbaja në zemër, gjithashtu.

Një ditë, teksa Arti ishte ulur shumë afër meje dhe ma kishte kapur dorën, papritmas në market hyri Astriti. Në çast më lëshoi trupi. Një rrëqethje e dridhi trupin tim... Edhe ai u prish në fytyrë dhe shpejt e shpejt u kthye e doli jashtë.

Të nesërmen erdhi përsëri dhe më pyeti kush ishte ai. I thashë: "Kur të mbushet mendja të fejohe mi, eja e të tregoj për të!". Sidoqoftë, në mendjen time janë dy persona dhe për të dy vuaj njësoj, për të dy shoh ëndrra njësoj.

Nuk di si të veproj tutje... Veç të martohem me dy burra bashkë...

D. Pëllumbi



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

Profesoreshë, a ma jep?!

“Shpejt kaluan katër vjet”, është një nga këngët e Mahmut Feratit. Por, tash shkolla e mesme i ka vetëm tre vjet. Megjithatë, maturantët mbajnë kujtime të ndryshme, herë-herë edhe qesharake...

VENITA: PROFA MË ZURI DUKE I SHKRUAR POEZI!

“Tre vjet si tri ditë! Kemi kaluar një periudhë ku herë mbahej mësimi e herë e përcillnim online, shkaku i pandemisë. Rasti im i paharruar është kur i shkruaja poezi profës së gjuhës shqipe. Insistoi të lexoja atë që kisha shkruar dhe e kuptoi

fill e për pe se atij ia kisha kushtuar. Sepse, pasi e lexova, qeshi...”

VESA: SHOKU IM I BANKËS ME PASQYRË IA SHIHTE KËMBËT PROFESORESHE!

“Profesoresha e anglishtes në shkollën tonë, vërtet, është e bukur, por edhe e re. Flokëgjatën jo vetëm që e donin djemtë, por edhe ne, vajzat.

Në shkollë vinte e veshur bukur dhe, kryesisht, me fund. Shoku im i bankës e vendoste pasqyrën në një kënd ku profesoreshës ia shikonte këmbët”.

LAUREATI: PROFESORESHE, A MA JEP?

“Klasa ime kemi qenë më problematike në shkollën tonë. Kohën më të madhe e kalonim duke qeshur. Më problematiku ishte Atdheu. Profesoresha, kujdestare e klasës, e uli në bankën e parë, që ta kishte sa më shumë nën kontroll.

Një ditë profesoresha na tha të shkruanim shkurtimisht për romanin “Sikur t’isha djalë” të Haki Stërmillit. Por, ai s’kishte pasur laps me vete.

“Profesoreshë, a ma jep?”

“Hë, kë?”, i tha ajo me habi.

“A ma jep lapsin?”, ia ktheu ai.

Ne qeshëm. Dhe, nga qeshja jonë profesoresha u ndie keq. E qortoi që herëve të tjera të di të pyes si duhet”.

LEARTA: PROFESORI NA QUANTE DËRRASË!

“Profesori i edukatës fizike e ka pasur shprehi që kur nuk vraponim sa duhej, neve vajzave, na quante “dërrasë”.

“Pse na quan dërrasë?”, i pat thënë shoqja ime, Melinda.

“Dërrasë, sepse po vraponi pa e shliur trupin. Pa i shliur krahët!”, ia ktheu ai.

FESTIMI: PROFESORI I EDUKATËS FIZIKE E LAVDËRONTE VETEN!

“Në orën e edukatës fizike, kur ndodheshim në sallë, profesori i edukatës fizike e lavdëronte veten se si ka lexuar me qindra romane...

Mentorja, shoqja ime e bankës, dinte të krijonte humor aty për aty. Në një rast, teksa ai e lavdëronte veten se ka lexuar me qindra romane, i tha:

“Profesor, a e ke lexuar romanin që ende nuk ka dalë?”.

“Bile moti, oj çurë!”, ia ktheu.

Ne, nxënësit, desh vdiqëm duke qeshur...”

PËR FUND

Sidoqoftë, kujtimet nga bankat e shkollës së mesme janë më të paharruarat. Por, që dy vjet nxënësit më shumë kanë mësuar online shkaku i pandemisë sesa në shkolla. Megjithatë, kanë kujtime e që ia vlen të shkruhen...

D. H.

Fëmijët s'më konsiderojnë as për qen!

Biondinën që dikur e ëndërroja, meqë kishte mbetur shtatzënë, ma sollën në shtëpi. Dhe, nga ajo ditë filluan grindjet në familjen time, sa që një ditë, gruaja, bashkë me fëmijët morën botën në sy, ndër-sa unë nga ajo ditë jetoj me probleme të reja...

"Isha djalë i vetëm në familje dhe si i tillë u rrita në kushte të mira. Prindërit më vdiqën herët, por më kishin lënë pasuri të mjaftueshme, andaj shkollimin e ndjeva obligim.

Në atë kohë arsimi kishte perspektivë, andaj edhe u regjistrova në Fakultetin Filozofik, edhe pse isha i martuar dhe i kisha dy fëmijë.

Dhe, pas kryerjes së studimeve u punësova në një shkollë fillore të rrethit të Prishtinës, me qëllimin që më vonë të kthehesha në vendlindje, por s'më doli ashtu...

U DASHUROVA MARRËZISHT NË KOLEGEN TIME

Vitin e parë në këtë shkollë e kalova pak me vështirësi, shkaku i rrethit të ri. Por, edhe shkaku se jetoja larg gruas e fëmijëve.

Por, në vitin e dytë të punës gjërat ndryshuan: u dashurova marrëzisht në një kolege timen, me të cilën njiheshim që nga koha e studimeve.

Ditët kalonin e dashuria ime për të sa vinte e shtoej. Ajo nuk e dinte se unë isha i martuar, sepse këtë e mbaja sekret gjithmonë, madje edhe në rastet më të gëzuara.

Në anën tjetër, biondinës çdo ditë i kërkoja të pinim kafe bashkë. Kërkesa dhe këmbëngulësia ime ishin të vazhdueshme. Por, ajo, si nga frika, i ikte kërkesave të mia. Ikte nga biseda dhe më vidhte me bisht të syrit në sallën e arsimitarëve, herë-herë duke lëshuar edhe ndonjë buzëqeshje të ëmbël. Një ditë rastësisht e takova në qytet. E luta për kafe dhe pa hezitim pranoi. Dhe, që nga ajo ditë takimet tona filluan të shpeshtoheshin.

Por, që të jemi sa më afër njëri-tjetrit na e mundësoi ekskursioni katër ditë në Shqipëri. Mbrëmjen e parë dolëm nëpër plazhin e gjatë të Durrësit. Pas një ecje të ngadalshme, u ulëm në një vend të përshtatshëm përballë detit. Ulja ma mundësoi që t'ia hapja zemrën dhe ia thashë troç të gjitha...

Ditën e tretë ishim në Sarandë. Atë natë ndenjëm më gjatë bashkë sesa herëve të tjera. Pasi iu afrova shumë afër, ia preka flokët dhe ia dhashë një puthje. Më pastaj, natën e kaluam në një hotel bashkë, larg kolegëve të punës.

BIONDINËN MA SOLLËN NË SHTËPI!

Pas tre muaj bashkë, më tha se ishte shtatzënë, ani pse më nuk kemi fjetur bashkë pas rastit në Sarandë.

I thashë të abortonte, por nuk pranoi. E unë kësaj pune një kohë nuk ia vura veshin...

Një të diel, në mbrëmje u ktheva nga fshati, si rëndom. Para se të hyja në banesë pash një veturë dhe dikë brenda. Por, meqë ishte kohë muzgu nuk i njoha. Posa hyra brenda një e rënë zili më shqetësoi. Kur hapa derën, ishte ajo, biondina që e dashuroja me dy vëllezërit e saj, që deri

në atë moment nuk i njihja.

"Ta sollëm, se vetë e ke bërë punën me ta sjell!", më thanë dhe u nisën shkallëve teposhtë.

Dhe, s'më mbeti tjetër veç t'i dëshiroj biondinës sime "mirëseardhje".

S'di si e kam kaluar atë natë. Ishte nata më e tmerrshme në jetën time...

Dhe, për çudi, herën e parë që shkova në fshat pas ardhjes së biondinës, gruaja dhe fëmijët e kishin mësuar të vërtetën time. E, nga kush nuk di!

GRUAJA IKU BASHKË ME FËMIJË!

Nga ajo ditë gruaja haptazi e shprehte mllëfin e saj ndaj meje. Njëjtë ishte edhe me fëmijët...

Dhe, nga ajo ditë jeta ime filloi të bëhej gjithnjë e më e pakuptimtë.

Të dielën e dytë, posa shkova në fshat, gruaja më kishte pritur t'më tregonte se do largohej nga shtëpia...

Dhe, kur mori valixhen me tesha, fëmijët iu qepën pas...

E, kjo ngjarje për mua ishte më shumë se tragjike. Më mirë ishte po t'më kishte rënë qielli mbi kokë...

Dhe, tre vjet rresht nuk kam ditur gjë për ta. Së pari kishin shkuar në Shqipëri, pastaj në Itali, kështu më tha djali i madh kur u lajmërua pas tre vjetësh në telefonin tim, duke ma bërë me dije se më nuk më njohin për babë, madje as për qen...

Por, nejse, këtë e kisha merituar, sepse u bëra shkaktar i prishjes së familjes, i prishjes së rahatisë së tyre...

Dhe, nga ajo kohë prehen e gjej në shoqëri të gotës, e që po ma brenë shëndetin dita-ditës...

D. Rudhani

Pse disa burra tradhtojnë edhe kur dashurojnë?



Të flasësh për dashurinë është gjithmonë e ndërlikuar, sepse marrëdhëniet janë komplekse dhe mënyrat se si i jetojmë ato janë të ndryshme. Do të ishte mirë nëse do të mund të përjetonim dashurinë siç tregohet në përralla. Megjithatë, ndjenja më e fortë në botë njih shumë forma që janë të panjohura për ne. Dashuria është e paparashikueshme, ashtu si njerëzit. Ata që, pavarësisht premtimeve të tyre të përvetshme, tradhtojnë.

Ka shumë tradhti që i helmojnë marrëdhëniet, i shkatërrojnë ato dhe ndonjëherë i bëjnë më të forta se më parë. Mjafton vetëm të vëzhgojmë njerëzit rreth nesh për të zbuluar se edhe çiftet në dukje më solide, kanë pësuar reagime për shkak të pranisë së një personi të tretë.

EDHE TË DASHURUARIT TRADHTOJNË!

Ndoshta është e vërtetë që ata që duan nuk tradhtojnë, por është, gjithashtu, e vërtetë që ata që tradhtojnë, ndonjëherë janë të dashuruar! E vërteta është se ai gjithmonë tradhton veten për një arsye, edhe kur në dukje nuk duket se është aty. Por, përvojat ndonjëherë na mësojnë se nuk është kështu.

Sidoqoftë, ka shumë shkaqe që çojnë në tradhti, disa prej tyre të deklaruara hapur, të tjera të pashprehura kurrë. Megjithatë, ata që tradhtojnë e bëjnë gjithmonë për një arsye që nuk lidhet domosdoshmërisht me mungesën e dashurisë. Sigurisht, ka nga ato raste në të cilat një person lë kokën për një tjetër dhe ato vërtetojnë se nuk mund të bëjmë asgjë kundër paparashikueshmërisë së zemrës.

Por, për të gjitha rastet e tjera ka arsye pak a shumë të thella...

Ju, pa dyshim, tradhtoni sepse ndonjëherë jeni të papjekur emocionalisht dhe kjo çon në gabime pas gabimeve, edhe nëse keni një zemër të zënë. Herë të tjera bëhet për të kërkuar atë emocion që i përkiste çiftit gjatë periudhës së rënies në dashuri dhe që

duket se kthehet pikërisht në aventurat e një nate.

Herë të tjera mungon synimi për të qenë monogam, për t'iu përkushtuar vetëm dhe ekskluzivisht një personi. Dhe, edhe në këtë rast, sigurisht, nuk mund ta fajësojmë dikë, mjafton të jesh i sinqertë me partnerin. Dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, është mërzia, ajo që ndodh kur rutina dhe zakonet bëhen mbytëse.

TRADHTIA NUK I ZGJIDHË PROBLEMET!

Sidoqoftë, tradhtia nuk është kurrë zgjidhja e problemeve të marrëdhënieve, sepse, pavarësisht gjithçkaje, ky akt kthehet në një traumë të vërtetë emocionale që vështirë fshihet.

A je hudum, o hajvan!

E dija se nuk isha ndër ata tipa që femra posa i shikon edhe neveritet. Mirëpo, edhe pse dukeshja disi tërheqës, karakteristik dhe i butë me gjininë femërore, prapëseprapë nuk ia dilja të bëja kurrë një të dashur...

Më vinte inati nga shokët e mi kur thoshin se kanë bërë dashnore, ndërkaq unë vetëm i imagjinoja puthjet me to, të prekurat dhe ledhatimet...

Nuk mund të dilja ballë për ballë me asnjërin, shkakun se turpërohesha dhe bëhesha flakë në fytyrë! Vuaja si mashkull, aq më tepër kur femrat më provokonin në rrugë...

Dhe, për djemtë si unë aso kohe flitej kështu: të shumëvujtur në rini, të hareshëm në pleqëri!

FEMRAT NUK MA ZGJONIN EPSHIN!

Tani jam i moshuar, kënaqësitë që mund të më jep seksi po veniten. Jam i pasur, por sot kjo s'ka rëndësi, edhe pse dikur sorolatesha rrugëve të Prishtinës me duar në xhepa. Por, nuk u zhyta asnjëherë nëpër rrugë të errëta...

Krijova një fytyrë të mirë me femra, e që m'u dha mundësia të njihja gjithfarë. Por, unë, edhe kur arrita të bëhesha 25 vjeç, ende isha beqar. E kjo ndodhte meqë

femrat nuk ma zgjonin epshin...

Më kujtohet se një pasdite erdhi në shtëpinë tonë një fqinje, bashkë me të bijën që ishte më e vjetër se unë. Me mua në shtëpi ishte vetëm nëna, meqë babai ende s'kishte ardhur nga puna.

Dhe, me Lumen shkua në dhomën time për të luajtur në kompjuter. Por, posa hymë në dhomë ajo e mbylli derën me çelës. "Për siguril", më tha. Dhe, hapi gjoksin, kinse kishte vapë. Më pas më tha: "Do hymë në kompjuter dhe do shohin një film erotik".

Dhe, pa humbur shumë kohë, hasi në një film, vërtet erotik. Kishte puthje, ledhatime, seks dhe gjithçka tjetër që bëhet në dhomën e gjumit.

Në ato çaste, pa dyshim, u tremba... U ngrita në këmbë dhe u nisa drejt derës. Por, ajo shpejt më kapi për krahu dhe më tha: "A je mashkull, o hajvan!".

Në çast u shtri në dyshe me, ngriti fustanin dhe hapi këmbët. Por, për mua pamjet e tilla ishin qesharake, sepse nuk ndieja kurrfarë eksitimi...

I DASHURUAR NË VETVETE!

Ç'është e vërteta, asnjëherë nuk kisha guximin të kërkoja nga ndonjë femër atë që më nevojitej mua, nga që e ndjeja veten të pafuqishëm erotikisht. Para tyre isha një hudum dhe hiç më shumë.

Luftoja me vetveten se si nuk isha në gjendje ta bëja për vete një nga ato femrat që më vardiseshin, por unë asnjëherë nuk mund t'i ledhatoja, e të mos flasim t'i puthja a t'i thosha "ti je e dashura ime".

Kështu, pësoja disfatë morale e shpirtërore, ku, në fakt, disa femra haptazi shprehnin simpati për mua, kurse "hija" im i largonte! Trembesha nga vetja herë-herë, por kjo nuk do të thotë se kisha nevojë të hospitalizohesha.

Sot jam tërësisht i pashpresë dhe pa askënd afër meje. Nuk do të ketë në botë një njeri që do t'më kuptoj. E pranoj fatin tim të zi dhe nuk mund ta ndryshoj më, meqë jam në moshë të shtyrë.

R.H.

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Më bente dhunë, e paraqita në polici!

Përhëndetje zonjë! Jam 34-vjeçare, jetoj në Zvicër. Jam nënë e një fëmije.

Me burrin jemi dashur, por ka një vit që nisi dhunën ndaj meje. Dhe, një ditë, pasi më ra grusht, e paraqita në polici.

Ai ka për t'u paraqitur në procedurë të rregullt gjyqësore, por, meqë jemi përsëri në një lloj bashkëjetese, po mundohet t'më hakmerret pse e kam paraqitur në polici. Si do të jetë e ardhmja jonë?

"Dielli nuk po ngrohë"

Përgjigje:

Nëse e ke paraqitur për dhunë fizike ndaj teje, nuk ke gabuar. Ai disa ditë ka sjellje të mira, disa ditë të këqija dhe të shkakton probleme, që të lëndojnë dhe traumatizojnë.

Ti nuk duhet të heshtësh dhe duhet t'ia kujtosh atij se jeta nuk shkon me probleme. Hapi rrugën nëse do të jetojë jetë bashkëshortore ose zyrtarizojeni ndarjen.

Nuk shoh se keni për të jetuar bashkë, sepse te ai ka ndikim negativ familja.

Gruaja nuk ka ndjenja për mua!

Përhëndetje, jam 35-vjeçar, jetoj në Ferizaj. Kam një firmë mesatarisht biznesi.

Por, kam probleme me grua. Ajo nuk ka ndjenja ndaj meje dhe kjo gjë më bën shumë nervoz.

A ka tjetër, apo nuk më do mua?

"Pritja"

Përgjigje:

Ju nuk keni marrëdhënie të rralla intime. Kjo sjell dyshime në jetën tuaj bashkëshortore. Jeni para një krize që mund të shpërthejë në çdo moment, me akuza apo gjysmë akuza... Bashkëshortja duhet ta jep shpjegimin e vet për këtë gjendje dhe të gjeni mirëkuptim, nëse keni krizë bashkëshortore në intimitet.

Është mirë ta kontaktoni edhe psikiatr, i cili do të gjejë, me siguri, defekte të mungesës emotive mes jush.

Më e mira e të mirës do ishte që bashkëshortja ta arsyetoj veten për këtë mungesë emocionale ndaj teje, por ka mundësi që ajo edhe të të hakmerret ndaj një kohe që, gjithashtu, ti nuk ke shprehur shumë ambicie ndaj saj.

Pse jam xhelozë?

Jam nga Prishtina, e martuar që dy vjet, e pa punë. Më ka hy një mendje e keqe ndaj burrit dhe jam tepër xhelozë sa vendi vend nuk më zihet, edhe pse ai sillet mirë me mua, dalim bashkë dhe kujdeset në maksimum për çdo gjë.

Unë mundohem të nxisë probleme çdo ditë, duke e pyetur rreth punës dhe kontakteve.

A do të kalojë kjo gjendje, e që po më bën edhe më shumë të mërzhitem?

"Zemra"

Përgjigje:

Duke qenë shumë xhelozë, ti po e përlulë vetveten te burri dhe po e ngritë atë më shumë se që duhet.

Kështu, po krijon një paralele debalanci bashkëshortor, ku ai gjithnjë arsyetohet para teje. Ndërkaq, ti, me faktin që je në shtëpi, sikur nuk mund të bësh gjë pas shpinës së tij.

Të kuptohemi se sot me mjetet komunikuese, çdo kush ka mundësi të të bëjë pas shpine diçka jashtëmarte-sore...

Edhe ai ka ta drejtë të të hidhet ty pse qëndron në telefon gjatë tërë kohës, por nuk e bën.

Ndërpreje këtë sjellje, sepse rrezikon martesën! Ai të duron, por edhe durimi ka fund. Nuk shoh arsye pse duhet ta kesh këtë xhelozë enorme...

Po komandon në shtëpi burri i huaj!

Jam 41-vjeçar, nga rrethi i Prishtinës. Kam grua dhe dy fëmijë. Punojmë unë dhe gruaja, por gruaja disi më ka futur në dyshime se më shumë e përfill kolegun e vet sesa mua për çdo punë të shtëpisë.

Çdo gjë që duhet të punohet, ajo thotë se kështu vepron kolegu im dhe nuk duhet kështu, siç them unë. Ne kemi një muhabet familjar me kolegun e saj, por më duket pak si tepër që për asgjë të mos vlejë e imja, gjë që po më hyjnë dyshime...

"Fleta"

Përgjigje:

Këtu është një e keqe se, në prani të familjes, ta degradon imazhin prej burri! Në anën tjetër, çdo gjë që bën a investon në shtëpi, kualiteti luan rol. Nuk duhet të prekesh nëse gruaja di më mirë, për shembull, sepse ka shumë gra që dinë më mirë kur është në pyetje shtëpia.

Nuk është gabim as të shfrytëzohet përvoja e ndokujt që di më mirë të bëjë zgjidhje për shumë probleme infrastrukturore në shtëpi.

E vetmja gjë që duhet arsyetuar është mënyra se si e thotë gruaja. Unë nuk shoh gjë të keqe sa i përket dyshimit tuaj lidhur me gruan në vendin e punës...

Egërsimi i burrit

Jam një grua e martuar, kam fëmijë, por nuk i kemi mirë punët me burr-

in. Është bërë tepër i egër ndaj meje dhe fëmijët po hutohen shumë kur po shohin sjelljen e tij, bile më pyesin se çka kam bërë unë që ai nuk më shikon, as nuk më flet...

Nuk di çka sjellë e nesërmja, sepse ai është tepër agresiv dhe i huaj për mua!

Të lutem, më ndihmo dhe a mundesh të ma kthesh burrin si dikur që e kisha për vete?

“Nëna e shtëpisë”

Përgjigje:

Disa profesione ku punojnë sot gratë, krijojnë distanca me burrin deri në masën që keni shpjeguar ju. Femra e ambientit tonë në punën e lëmit mjekësor, duhet ta ketë unin e vet e jo të vallëzoj sipas unit që e gjen aty ku punon.

Kur shkon të punosh diku si grua, duhet ta kesh një qëndrim tëndin dhe një mënyrë pune që i ndalon vetë të tjerët të mos shprehen para teje me gjuhën joparimore. Secila femër që punon e krijon bindjen tek të tjerët, në varësi prej asaj se çka reflekton vetë dhe ti këtu ke bërë rrëshqitje. Bisedat e pamatura me kolegët, sjelljet e tjera që për burrin janë të papranueshme, kanë ndikuar shumë ashpër në raportet tuaja bashkëshortore.

E, këto raporte mund të rregullohen falë rritjes së besimit tënd te ai.

Dhe, pa marrë parasysh se je koleg me dikë që punon, gruaja është grua dhe mashkulli është mashkull...

Vuaj nga ëndrrat e tepërta dhe pagjumësia

Jam N. Z., 50 vjeçe, punonjëse e lartë e arsimit. Kam probleme me ëndrra, posaçërisht sivjet. Asnjë natë nuk më kalon pa parë diçka ëndërr.

Në mëngjes zgjohem e frikësuar, duke menduar se çka do të ndodhë gjatë ditës...

Çka të bëj që të jem me gjumë të mirë?

“Jeta dënon”

Përgjigje:

Ëndrrat kanë zgjuar gjithnjë interesimin e psiko-analistëve dhe

psikologëve për të ardhur te e vërteta se çka, në fakt, tregojnë.

I pari që ka bërë publik mendimin më shkencor për ëndrrat është Sigmund Frojdi, psiko-analist i madh i të gjitha kohëve, mendimi i të cilit u shndërrua në shkollë të psikanalizës në tërë botën. Mendimi i tij publiko shkencor erdhi në vitin 1900 në Vjenë, me botimin e librit voluminoz për ëndrrat.

Megjithatë, në këtë pyetje, për shkak të hapësirës së kufizuar, po mundo-hem sa më shkurt t’u përgjigjem: Sigmund Frojdi, më vonë edhe Karl Gustav Jung, thonë se ëndrrat janë si fasada e shtëpisë.

Çka do të thotë kjo?

Kjo do të thotë se me ëndrrën e bukur që mund të shihet në mënyrë të pavetëdijshme gjatë procesit të gjumit, fshihet një rezervat i madh gjërash, që nuk duken.

Ato që nuk duken dhe që mund të jenë tepër të këqija dhe të rrezikshme, mund të fshihen nën fasadën e objektit. Nga 700 ëndrra të analizuara të një psiko-analisti, ka rezultuar se rreth 100 prej tyre kanë pasur direkt lidhje me proceset jetësore të së kaluarës dhe të së ardhmes.

Kjo tregon se nën këtë fasadë që ne e mohojmë, ekziston diçka e mirë apo e keqe që ndodhë apo që do të ndodhë.

Ëndrrat, pastaj, aludojnë edhe në sugjestionet e ndryshme, qëkur njeriu takohet me një realitet rasti në ambient, në shtëpi, në punë, në rrugë, në dhomë, në natyrë apo kudo tjetër sheh se dukuria që e rrethon në atë moment është kopje e një ëndrre që i është shfaqur para një apo dy vjetësh. Në këtë pikë, njeriu ndalet dhe mendon:

Çka po ndodhë, pse tash kjo storie apo pamje reale e asaj ëndrre dhe fillon të stresohet dhe të shfaqë ankth se diçka po ndodhë apo do të ndodhë?!

Pikëtakimi me një ëndërr ka kuptim, por jo gjithnjë. Ëndrrat janë pjesë e jetës dhe pjesë e një ritmi real që ndodhë në jetën e secilit person. Sipas Frojdit ëndrrat janë pjesë e jetës dhe në procesin kur ato ndodhin,

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

paraqesin një konfuzion ngatërrimesh herë të bukura e herë të shëmtuara.

Por, në pikëpamjen profesionale ato shpjegohen dhe kanë domethënie shumë të caktuar...

Ëndrrat janë rezultat i aktivitetit psikik dhe i ndjenjave organike që japin bashkë një funksion kuptimi që ka shpjegim.

Megjithatë, në rastin tënd, ti ke kaluar në kompleks psikik, duke i vënë vetes pyetje të përditshme se çka po ndodh me mua! Je kompleksuar dhe kjo gjendje tash reflektohet te ti si një problem që të lë pa gjumë, të bën të zgjohesh natën dhe të qëndrosh para televizorit, pastaj bien e shqetësuar se çka do vjen në ëndërr e çka po prodhon dita e nesërme...

Andaj, kur do të flesh, mos mendo për ëndrrat! Mos bjer nën presionin e ankthit dhe çdo gjë do të stabilizohet.

Kam frikë, nuk guxoj të dal askund!

Kam një problem që sa vjet. Jam 34-vjeçare, jetoj në Lipjan. kam shumë frikë sa nuk kam guxim të dal nga shtëpia! Nuk i kam treguar familjes për çdo detaj të frikës sime, por u kam treguar se frikësohem... Po dyshoj se kam magji!

“Magjia”

Përgjigje:

Frika, de fakto, është një lloj magjie. Nuk është e thënë që dikush të ka bërë diçka, ashtu si mendojnë shumica... Kush të ka bërë magji?

Vetë fakti se ke frikë të paarsyeshme, tregon se je nën një lloj magjie.

Mirë është të paraqitesh në Skajp te unë, ku i bëj bisedat. Dhe, pas bisedës me ty, më saktë besoj se do të bindesh që ta eliminosh frikën dhe të fillosh të dalësh për çdo punë tënden kudo që do vetë...



SHERWOOD

Resorts and Hotels

**SHERWOOD
EXCLUSIVE KEMER**
KEMER / ANTALYA

**SHERWOOD
EXCLUSIVE LARA**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
DREAMS RESORT**
BELEK / ANTALYA

**TUI BLUE
BELEK**
BELEK / ANTALYA

**SHERWOOD
SUITES RESORT**
LARA / ANTALYA

**SHERWOOD
GREENWOOD RESORT**
KEMER / ANTALYA